



...for better journalism

MediaWise Trust




United Nations Children's Fund
(UNICEF)



Botim i Institutit Shqiptar të Medias

MEDIA DHE TË DREJTAT E FËMIJËVE

Nga gazetarët për gazetarët



Media dhe Të Drejtat e Fëmijëve

PËRMBAJTJA

Faqe

- 3. Si ta përdorni këtë udhëzues
- 4. Profesionistët e medias dhe të drejtat e fëmijëve
- 6. Fëmijët me paaftësi
- 8. Fëmijët dhe diskriminimi
- 10. Fëmijët dhe familja
- 12. Puna e fëmijëve
- 14. Fëmijët dhe konflikti i armatosur
- 16. Shëndeti dhe mirëqenia e fëmijëve
- 18. Identiteti i fëmijës
- 20. Mendimet dhe liritë civile të fëmijëve
- 22. Fëmijët në kujdesin publik
- 24. Fëmijët dhe media
- 26. Fëmijët në media
- 28. Arsimi
- 30. Fëmijët dhe krimi
- 32. Abuzimi seksual dhe shfrytëzimi i fëmijëve
- 34. Përgjegjësitë e shtetit

Shtojca

- 36. 1. Konventa mbi Të Drejtat e Fëmijës
- 44. 2. Synimet e Mijëvjeçarit të OKB-së
- 46. 3. Një Botë e Përshtatshme për Fëmijët
- 48. 4. Udhëzime të Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve
- 50. 5. Udhëzime të Organizatës Botërore të Shëndetësisë
- 51. 6. Kalendar 'Pineskash'
- 53. 7. Kontakte të Dobishme Ndërkombëtare

Ky udhëzues është hartuar për të ndihmuar profesionistët e medias që punojnë për raporte mbi fëmijët, që të vlerësojnë të drejtat e fëmijëve dhe të nxisin pjesëmarrjen e tyre në masmedia. Ai përmban ide dhe sfida për gazetarët, si dhe për ata që kërkojnë të sigurojnë mbulim nga media për nevojat, problemet, arritjet dhe aspiratat e fëmijëve.

Qëllimi i tij është që të nxisë mbulim të përgjegjshëm për fëmijët dhe ndikimin e sjelljes dhe vendimeve të të rriturve mbi jetën e tyre. Udhëzuesi ka shërbyer si bazë për programe trajnimi për gazetarë anëmbanë botës, mbështetur nga UNICEF dhe Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve.

I porositur fillimisht nga UNICEF në vitin 1999 për të festuar dhjetëvjetorin e Konventës së OKB-së për Të Drejtat e Fëmijëve, ky udhëzues bazohet mbi përvojën praktike të gazetarëve në detyrë dhe u hartua nga organizata bamirëse në fushën e medias me qendër në Mbretërinë e Bashkuar MediaWise (më parë njohur si PressWise).

Kërkimi dhe zhvillimi

*Botimi i parë: Mike Jempson & Denise Searle.
Botimi i dytë: Charlotte Barry & Mike Jempson.*

*MediaWise dhe UNICEF mbajnë të drejtën e autorit për përmbajtjen e udhëzuesit. Megjithatë, materialet mund të riprodhohen për qëllime trajnimi me kusht që burimet të informohen dhe të njihen.
[Shihni kopertinën pas për hollësi për kontaktet.]*

NUMRI ISBN: 0-9547620-3-7
Botuar: Janar 2005

Si të përdoret ky udhëzues

Profesionistët e medias janë në vendin e duhur për të mbajtur të drejtat e fëmijëve në axhendën e lajmeve, duke shqyrtuar përpjekjet për t'i mbrojtur ato të drejta dhe duke sfiduar ata që dështojnë në përmbushjen e angazhimeve të veta kundrejt fëmijëve.

Ky udhëzues është ndërtuar me qëllim që gazetarët t'i kuptojnë sa më mirë të drejtat e fëmijëve dhe për të sugjeruar se si çështja mund të nxisë për gatitjen e raporteve dhe reportazheve të lajmeve për median e shkruar dhe atë elektronike.

Ai identifikon IDE PËR RAPORTE bazuar mbi tema të nxjerra nga Nenet e Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi Të Drejtat e Fëmijëve, si dhe ofron LISTA VERIFIKIMI për të ndihmuar profesionistët e medias të masin shkallën e njohjes së të drejtave të fëmijëve.

Shtojcat përfshijnë një drejtues të thjeshtë për Konventën dhe shënjestrat e OKB-së për të përmirësuar jetën e fëmijëve, të cilat shumica e vendeve të botës i kanë nënshkruar. Ka udhëzime etike për profesionistët e medias, një kalendar 'pineskash' që lidhin raportet, dhe mbi 60 kontakte ndërkombëtare të dobishme nga të cilat gazetarët mund të marrin fakte, shifra, citime dhe këshilla.

Shpresojmë se do të jetë i dobishëm për zhvillimin e mbulimit të saktë dhe pozitiv të fëmijëve kudo.

Lynn Geldof

Këshillues Rajonal për Komunikimin
UNICEF Europa Qendrore Lindore
& Shtetet Bashkësisia e Shteteve të Pavarura

Mike Jempson

Drejtor
The MediaWise Trust

Profesionistët e Medias dhe të Drejtat e Fëmijëve

Gazetarët janë avokatë të të drejtave të njeriut. Ata veprojnë si sytë, veshët dhe zërat e publikut, duke tërhequr vëmendjen ndaj abuzimit të pushtetit dhe të drejtave të njeriut, shpesh duke vënë veten në rrezik të konsiderueshëm. Me anë të punës së tyre, ata mund të nxisin qeveritë dhe organizatat e shoqërisë civile që të realizojnë ndryshime që përmirësojnë cilësinë e jetës së njerëzve.

Gazetarët, fotografët, dhe prodhuesit e programeve shpesh ekspozojnë mundimin e fëmijëve të zënë në rrethana përtej kontrollit të tyre, apo të abuzuar a shfrytëzuar nga të rriturit. Megjithatë, është po aq e rëndësishme të merret parasysh 'këndvështrimi i fëmijëve' në mbulimin më konvencional të lajmeve. Një mënyrë e mirë për të testuar vlerën e ndryshimeve në ligj apo politika fiskale, për shembull, është të shqyrtohet masa në të cilën fëmijët do të përfitojnë apo vuajnë si rezultat i tyre.

Mënyra në të cilën media përfaqëson, apo edhe injoron, fëmijët mund të ndikojë në vendimet që marren në emër të tyre, dhe në ç'këndvështrim i sheh shoqëria ata. Media shpesh i përshkruan fëmijët thjesht si 'viktima' të heshtura apo 'të pafajshëm' të adhurueshëm. Duke u ofruar fëmijëve dhe të rinjve mundësitë për të folur për veten e tyre – mbi shpresat dhe frikërat e tyre, arritjet e tyre, si dhe ndikimin e sjelljes së të rriturve mbi jetën e tyre – profesionistët e medias mund ta kujtojnë publikun që fëmijët meritojnë të respektohen si qenie njerëzore individuale.

Konventa për të Drejtat e Fëmijëve

Konventa e Kombeve të Bashkuara për Të Drejtat e Fëmijëve (KKBDF) përcakton se çfarë duhet të bëjnë qeveritë dhe individët për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat njerëzore të pandashme të të gjithë fëmijëve. E adoptuar unanimisht nga Asambleja e Përgjithshme më 20 nëntor 1989, Konventa është ratifikuar nga të gjitha qeveritë e botës (me përjashtim të Somalisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës).

Ratifikimi i Konventës i angazhon qeveritë të sigurojnë që fëmijët mund të rriten në kushte të sigurt dhe mbështetëse, me akses ndaj arsimit dhe kujdesit shëndetësor me cilësi të lartë, si edhe ndaj një standardi të mirë jetese. Duke nënshkruar KKBDF, qeveritë bien dakort

të mbrojnë fëmijët nga diskriminimi, shfrytëzimi seksual dhe tregtar dhe dhuna, si dhe të tregojnë kujdes të posaçëm për jetimet dhe refugjatët e rinj. Ato gjithashtu pranojnë që fëmijët kanë të drejtën:

- të shprehin opinione, sidomos mbi vendime që ndikojnë tek ata;
- e lirisë së mendimit, shprehjes, ndërgjegjes dhe fesë;
- për një jetë private dhe të drejtën për të luajtur;
- të formojnë klubet dhe organizatat e tyre;
- të kenë akses ndaj informacionit – sidomos atij nga shteti dhe media;
- t'i bëjnë vetë të ditura idetë dhe informacionet.

KKBDF ofron një piketë me të cilën mund të maten përpjekjet e secilës qeveri për të përmirësuar jetët e fëmijëve. Çdo pesë vjet, qeveritë duhet të raportojnë mbi përparimin e bërë pranë Komitetit të OKB-së për Të Drejtat e Fëmijëve. Komiteti takohet me përfaqësues të qeverive dhe dëgjon pikëpamjet e organizatave joqeveritare (OJQ) përpara se të bëjë rekomandime mbi hapa të mëtejshme që duhet të ndërmerret çdo vend për të përmbushur detyrimet e veta.

Shumë vende kanë nënshkruar gjithashtu edhe Protokollin Opsionale të KKBDF që merren me përfshirjen e fëmijëve në konflikt të armatosur, trafikimin, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve. Këto hynë në fuqi në fillim të vitit 2002 dhe kërkojnë nga qeveritë të raportojnë në mënyrë specifike mbi përpjekjet për t'i luftuar këto forma shfrytëzimi. Gjatë kohëve më të fundit, shumë vende kanë rënë gjithashtu në një mendje të zbatojnë 'Protokollin e Palermos' të Konventës së OKB-së Kundër Krimin të Organizuar Ndërkombëtar, të nënshkruar në Dhjetor 2000, i cili merret me trafikimin e grave dhe fëmijëve.

Të gjitha shtetet anëtare të OKB-së kanë rënë në një mendje të punojnë drejt tetë Synimeve të Mijëvjeçarit, të cilat duhet të përmirësojnë në mënyrë domethënëse jetët e fëmijëve. Të paktën 150 vende kanë ratifikuar gjithashtu Konventën 182 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës mbi çrrënjosjen e formave më të rënda të punës së fëmijëve (përfshi shfrytëzimin seksual), e cila hyri në fuqi në vitin 2000. Vitet 2001-2010 janë deklaruar Dhjetëvjeçari Ndërkombëtar për një Kulturë Paqeje dhe Jo-Dhune për Fëmijët e Botës; dhe vitet 2003-2012 janë Dhjetëvjeçari i OKB-së për Alfabetizimin. Aspiratat që përfaqësojnë ato ofrojnë një shtresë të pasur lajmesh që gazetarët mund ta gërmojnë. Shqyrtimi nga media është një prej garancive më të mira që do të bëhen përpjekje serioze për të arritur ndryshime reale në jetët e fëmijëve.

Fëmijët me paaftësi

- Investigoni statusin ligjor dhe shoqëror të fëmijëve me paaftësi. A u mungojnë mundësitë e barabarta sepse nuk ka ligje mbi të drejtat e tyre, apo për shkak të paragjyqimeve? A variojnë qëndrimet dhe mundësitë në bazë të paaftësisë? Flisni me fëmijët se ku e ka burimin paragjyqimi. Ata mund të ndihmojnë zhbërjen e miteve dhe keqpërfaqësimeve mbi njerëzit që janë 'ndryshe' duke përshkruar përvojën e tyre.
- A kanë prindërit e një fëmije me paaftësi mundësi për të marrë këshilla, ndihmë financiare, dhe ndihmë praktike? Është falas apo 'varet nga siguracionet'? Raportoni mbi organizatat vetë-ndihmuese dhe të tjera që punojnë me fëmijë me paaftësi dhe familjet e tyre.
- Shumë fëmijë me paaftësi dështojnë të arrijnë potencialin e tyre sepse të rriturit mendojnë se nuk kanë ndonjë potencial. A u ofrohet mbështetje dhe nxitje për të marrë pjesë në shoqërinë civile? A konsultohen mbi nevojat e tyre të posaçme: shkollim, transport, akses ndaj ndërtesave publike, mjedise çlodhjeje, planifikimet për ndërtimin e qytetit, etj? Çfarë mbështetjeje kanë në dispozicion kur përballen me diskriminim?
- Fëmijët me paaftësi përballen me probleme praktike sepse nevojat e tyre të posaçme shpërfillen nga arkitektët, ndërtuesit dhe prodhuesit. Raportoni mbi produktet dhe shërbimet që rezultojnë nga një proces bashkëpunues projektimi, në vendin tuaj dhe tjetërkund. Si po e përmirëson shteti aksesin ndaj ndërtesave publike, transportit, etj?
- Ekspozoni keqtrajtimin në institucione për fëmijë me paaftësi – sidomos nëse fëmijët nuk kanë askënd që mund të flasë për ta. Kush i drejton dhe si i marrin fondet? Raportoni teknika pozitive trajtimi dhe përkujdesjeje në vendin tuaj dhe tjetërkund. Çfarë mendojnë fëmijët për këto?

Fëmijët me paaftësi

- Në fokus të raportit tuaj është personi apo paaftësia? E keni prezantuar subjektin tuaj me emër në fillim? I keni lejuar subjektet e raportit tuaj të flasin vetë? I keni pyetur fëmijët nëse duan dhe si duan që të përmendet paaftësia e tyre? Nëse keni përmendur paaftësinë e një fëmije, a ka qenë vërtet me rëndësi? Për shembull, nëse fëmijë me paaftësi bëjnë fushatë për t'i krijuar mundësi hyrjeje në një ndërtesë, paaftësia e tyre mund të ketë rëndësi, por jo nëse po bëjnë fushatë për të shpëtuar një zonë me vlera mjedisore, apo për të siguruar fonde për një kauzë që s'ka lidhje me paaftësinë e tyre.
- Fjalët që zgjedhim të përdorim mbi njerëzit me paaftësi mund të ndihmojnë për ndryshimin e qëndrimeve dhe të kuptuarit OSE për përhapjen e paragjyqimeve dhe injorancës. Keni përdorur gjuhën në mënyrë negative apo figurative, e cila mund të jetë e hapur për keqinterpretim, apo mund të shkaktojë ofendim tek njerëzit me paaftësi? Keni përdorur terminologji korrekte specifike, apo jeni mbështetur tek termat apo stereotipet 'popullore' që mund të jenë fyese apo të pandjeshme? Nëse keni dyshim, konsultohuni me një ekspert (përfshi fëmijët me paaftësi). Ka një dallim midis tërheqjes së vëmendjes ndaj pabarazive shoqërore që i vendosin fëmijët me paaftësi në disavantazh të padrejtë dhe përdorimit të gjuhës emocionale thjesht për të nxitur keqardhje.
- Mbani mend, një paaftësi mund të shkaktohet nga një sëmundje, por nuk është një sëmundje, dhe paaftësitë nuk janë ngjitëse. Fëmijët me vështirësi të mësuari nuk janë njësoj si fëmijët me sëmundje mendore; defektet e pamjes dhe të folurit marrin forma të ndryshme; njerëzit përdorin karrike me rrota për arsye të ndryshme; paraliza cerebrale, sindroma daun (Down), disleksia, apo efektet e rubeolës janë kushte të ndryshme. Jo të gjithë njerëzit me paaftësi janë të sëmurë kronikë; shumë nuk e shohin veten si viktimë të pashpresa; disa e shohin paaftësinë si një koncept të imponuar nga një shoqëri që nuk kujdeset për nevojat e të gjithë qytetarëve të vet.

Fëmijët dhe diskriminimi

- A është diskriminimi diçka e zakonshme në vendin tuaj, për shembull, kundër pakicave etnike? Zbuloni arsyet dhe efektet – sidomos mbi fëmijët. Jepuni fëmijëve që vuajnë, si rezultat i diskriminimit, mundësi për t'i treguar publikut se si ndikon mbi ta dhe si i bën të ndihen.
- A ka ndonjë agjenci qeveritare apo joqeveritare që mbledh dhe boton të dhëna mbi fëmijët në vendin tuaj? A e identifikojnë të dhënat diskriminimin kundër djemve/vajzave, të pasurve/të varfërve, atyre nga fshati/qyteti, të aftë/me paaftësi, grupeve etnike, etj.?
- A shtrihet njohja e të drejtave të barabarta për të gjithë tek vajzat dhe gratë e reja, refugjatët, të huajt, dhe imigrantët? Si trajtohen fëmijët nga grupet etnike prej shërbimeve të shëndetit, arsimit apo punësimit? Çfarë roli luan diskriminimi tek ngacmimi mes fëmijëve?
- Investigoni përparësitë e shtetit, shënjestrat dhe programet e aksionit afirmativ për të pakësuar diskriminimin. Si monitorohen ato dhe nga kush? Raportoni mbi punën e agjencive shtetërore që zbatojnë politikën e mosdiskriminimit, si dhe të OJQ-ve që punojnë për të kapërcyer paragjykimet kundër pakicave.
- Raportoni mbi masat e marra nga qeveria juaj për të siguruar që legjislativi, politikën dhe ofrimi i shërbimeve të jenë jodiskriminuese, përfshi strategjitë që adoptojnë për t'u marrë me probleme që zbulohen, për shembull, nga organizatat joqeveritare apo Komiteti mbi të Drejtat e Fëmijëve.
- Raportoni mbi përpjekjet e shtetit për të ndihmuar fëmijë në situata dobësie apo në disavantazh – ata që jetojnë në varfëri apo me HIV/SIDA. A ndajnë fëmijët se përpjekje të tilla po sjellin ndryshime?

Fëmijët dhe diskriminimi

- Gazetaria ka të bëjë me specifikat dhe faktet – po shpesh mbështetet mbi përgjithësime që nuk mbështeten nga të dhënat. A keni rënë edhe ju në këtë grackë, apo keni sfiduar pretendimet që tregojnë se fëmijët e një komuniteti të caktuar janë tërësisht përgjegjës për 'valë krimesh' apo se po dëmtojnë stabilitetin shoqëror? Përgjithësimet rrallë janë të vlefshme dhe nxisin diskriminimin kundër pakicave.
- A keni përmendur racën, origjinën etnike, fenë, apo paaftësinë e një fëmije? A është vërtet e rëndësishme për raportin?
- A jeni siguruar që termat që keni përdorur mbi anëtarë të grupeve të pakicave, apo vajza e gra të reja, të mos jenë fyese apo të mos nxisin stereotipet?
- A keni bërë supozime mbi origjinën kulturore, etnike, apo fetare të një fëmije? Kontrolloni faktet përpara botimit.
- A keni studiuar ndonjëherë botimet apo programet e prodhuara nga grupet e pakicave etnike apo për to, apo të keni folur me gazetarët që punojnë mbi to?
- A keni kontrolluar saktësinë e pretendimeve të ngritura nga grupet raciste apo nacionaliste, dhe keni kërkuar pikëpamje drejtpeshuese nga njerëzit që janë sulmuar – përfshi edhe fëmijët?
- A keni rikontrolluar aludimet 'zyrtare' mbi fëmijë romë apo të rinj nga grupe të tjera pakicash etnike? A keni kërkuar pikëpamjet dhe përgjigjet e fëmijëve?
- A është raporti juaj mbi fëmijët pozitivë me HIV apo që jetojnë me SIDA i saktë nga ana mjekësore dhe i bazuar? Raportet spekuluese apo sensacionale e nxisin paragjykimin ose e përkeqësojnë atë.

Fëmijët dhe familja

- Si përkufizohet 'familja' në ligj në vendin tuaj? A përfshin familjen e zgjeruar apo vetëm bërthamën familjare? A janë ligjet tuaja mbi familjen dhe procedurat për divorcet të drejta dhe në interes sa më të madh të fëmijëve? A kanë fëmijët të drejtë të shprehin mendimin e tyre për atë që ndodh kur gjykatat apo autoritetet sociale ndërhyjnë në jetët e tyre?
- Strategjitë e mbijetesës adoptuar nga familjet me një prind mund të çojnë në marrëdhënie të forta me interes njerëzor nëse trajtohen me ndjeshmëri. Ato janë edhe një barometër i mirë i efektshmërisë së politikave sociale, të tilla si ofrimi i kujdesit për fëmijët. Gjeni mënyra për të raportuar mbi fëmijët e rritur në rrethana familjare jokonvencionale, pa i vënë ata në rrezik. Raportoni mbi grupet e presionit që përpiqen të përmirësojnë gjërat.
- Investigoni shtatzaninë dhe prindërimin tek adoleshentët. Si e përballojnë nënat e reja? Si kanë reaguar familjet dhe miqtë e tyre? Çfarë ndryshimi mendojnë se do të sjellë moshën e vet në jetën e fëmijëve të tyre?
- A merret parasysh efekti mbi fëmijët përpara se të burgosen prindërit? A mund t'i mbajnë nënat e burgosura foshnjat me vete? Raportoni mbi kërkimet për ndikimin mbi fëmijët e tyre dhe fushatat për të përmirësuar mjediset.
- Si merret shteti me aplikimet nga familjet që dëshirojnë të hyjnë apo të largohen nga vendi? Raportoni mbi përpjekjet e familjeve për të qëndruar së bashku kur përballen me perspektivën e të ndenjurit të ndarë për shkak të rrethanave apo burokracisë. Pyesni fëmijët mbi ndjenjat dhe përvojat e tyre.

Fëmijët dhe familja

- A i ndihmon raporti juaj njerëzit të kuptojnë se si politika të reja të qeverisë mund të ndikojnë mbi familjet? A ofroni informacion që do t'i japë mundësi pjesëtarëve të publikut të ndihmojnë fëmijët që kanë nevojë për kujdes dhe mbrojtje, apo të marrin ndihmën e nevojshme nga organet qeveritare apo joqeveritare?
- A ndihmon raporti juaj për të shpjeguar se si funksionon ligji i familjes? Për shembull, kur mbulon procedura divorcesh ku janë të përfshirë fëmijët, a del qartë në raportin tuaj se çfarë të drejtash kanë fëmijët kur përcaktohet kontributi ushqimor, apo kur merren vendime se me cilin prind do të jetojnë?
- A është raportimi juaj mbi një betejë mes prindërish se kush merr kujdestarinë e fëmijës i bazuar mbi fakte dhe i saktë? A keni shmangur emrat apo përdorimin e fotove emocionalisht shfrytëzuese të fëmijëve? Nëse jeni duke raportuar mbi një 'divorc personash të famshëm' që kryhet pa mirëkuptim, keni marrë parasysh pasojat e mbulimit për fëmijët e tyre? A e keni diskutuar këtë me prindërit dhe avokatët e përfshirë?
- Kur shkruani për fëmijë nën kujdesin publik — shtëpi fëmije, shkollë me konvikt, familje kujdestarie, apo 'kujdestari e përkohshme' — a i keni kontrolluar rregullat mbi identifikimin dhe keni zbuluar nëse fëmijët mund të vazhdojnë t'i takojnë prindërit nëse duan? Aty ku është e mundur, i keni pyetur fëmijët dhe a i keni përfshirë mendimet e tyre?
- Aty ku fëmijët nuk janë në një pozitë ku mund të japin një mendim lirisht, a i ndoqët procedurat për të marrë lejen për të folur me fëmijët apo të rinjtë e përfshirë? A e respektojnë autoritetet të drejtën e tyre për të shprehur një opinion?

Puna e fëmijëve

- Publikoni raporte mbi përpjekjet (apo dështimet) e shtetit për të mbrojtur fëmijët nga shfrytëzimi ekonomik: fushata informative, standartizim dhe inspektim i vendeve të punës, arsimim, trajnim, etj. A i ka ratifikuar qeveria juaj Konventat 29 (1930) apo 138 (2000) të ILO-s mbi çrrënjosjen e formave më ekstreme të tilla si puna e detyruar, skllavëria dhe shfrytëzimi seksual komercial?
- Kërkoni forma të fshehura të punës së fëmijëve: fabrika të fshehta, punë të detyruar, prostitucion, vajza të mbajtura larg shkollës për të ndihmuar në shtëpi. Flisni me fëmijë që punojnë, por mbron identitetet e tyre. Me çfarë orari punojnë? Sa paguhen? Punojnë sepse zgjedhin ta bëjnë këtë, dhe janë të lirë të heqin dorë apo të organizohen? A kryejnë zyrtarët vizita për të kontrolluar kushtet? Çfarë bëjnë sindikatat?
- Kontrolloni origjinën e mallrave në dyqanet kryesore. A është në dijeni menaxheri se ku dhe si janë prodhuar? Nëse është përfshirë puna e fëmijëve, gjeni se çfarë mendojnë klientët, sidomos fëmijët.
- Disa familje mbështeten tek fëmijët për të ndihmuar sigurimin e të ardhurave bazë familjare apo për të mbajtur një biznes familjar. A shfrytëzohen fëmijët apo janë pjesë jetësore e ekonomisë së familjes? Me çfarë orari punojnë? A kanë mundësi të zgjedhin? A mbahen larg shkollës?
- E drejta e fëmijës për të luajtur përfshin lirinë për të eksploruar ide, për të përdorur imagjinatën, për të zhvilluar talente dhe për të ndërvepruar me të tjerët. Materialet speciale dhe imazhet për arrijtjet sportive të fëmijëve dhe veprimtaritë kulturore janë argëtuese dhe frymëzuese. Raportet mbi mungesën e mjediseve publike të lojës, apo shitja e tyre për të siguruar para të thata për sektorin publik, apo aksidentet e shkaktuara nga pajisje të rrezikshme lojrash theksojnë përgjegjësinë publike për sigurinë e lojës.

Puna e fëmijëve

- A i keni menduar tërësisht përfshirjet e një moshe minimale zyrtare për punë? A keni marrë parasysh pasojat afatgjata, për fëmijët dhe për shoqërinë, nëse disa njerëz përjashtohen nga mundësitë arsimore dhe shfrytëzohen për shkak të moshës, përmasave, seksit, apo shkathtësive?
- A keni publikuar raste punëdhënësish të ndjekur penalisht për shfrytëzim të fëmijëve, apo të penalizuar për kushtet në të cilat presin të punojnë të rinjtë? A keni kërkuar statistika mbi dëmtimet dhe vdekjet mes fëmijëve që punojnë?
- A keni shqyrtuar mënyra të sigurta për të përfshirë pikëpamjet apo zërat e fëmijëve që punojnë si pjesë e raportit tuaj?
- A keni tërhequr vëmendje ndaj formave më të dukshme të punës së fëmijëve – shitësit e rrugës, pastruesit e makinave dhe këpucëve, korrierëve, etj. – dhe keni zbuluar pse punojnë, për kë punojnë, dhe sa paguhen? A i thekson raporti juaj rreziqet me të cilat përballen fëmijët që punojnë dhe a i identifikon ata që janë fajtorë për shtrëngimin apo shfrytëzimin e tyre?
- A jeni konsultuar me OJQ (përfshi sindikatat) si burime raportesh mbi shfrytëzimin komercial? Ata mund të jenë gjithashtu në gjendje të identifikojnë kontakte të dobishme ndërkombëtare, si edhe tregje, për raportet tuaja.
- A e tregon mbulimi juaj dallimin midis zonave dhe mjediseve argëtuese të sigurta, që zhvillojnë imagjinatën dhe atyre të pasigurta? A e keni theksuar rëndësinë e mirëmbajtjes dhe mbikqyrjes së duhur? A keni shpjeguar se çfarë duhet të ndodhë nëse një fëmijë lëndohet në një mjedis lojrash? A keni pyetur yjet e sportit dhe të programeve argëtuese mbi përvojat e tyre të lojës si fëmijë?

Fëmijët dhe konflikti i armatosur

- Përqëndrohuni mbi efektet e konfliktit të armatosur mbi fëmijët – kërcënimet e drejtpërdrejta ndaj jetës, shëndeti psikologjik dhe fizik, zhvillimi personal; ndikimet e tërthorta mbi shërbimet për fëmijët dhe familjet e tyre. Raportoni mbi rreziqe të tjera për fëmijët – nga mbylljet e gjata të shkollës apo traumat e shkaktuara nga sulmet ajrore, etj – dhe mënyrat në të cilat mund të ndihmohen apo mbrohen. Shtojini kontekstit politik anën njerëzore.
- Shumë fëmijë vriten apo gjymtohen nga minat anti-personel. Cila është historia e qeverisë suaj mbi prodhimin dhe vendosjen e minave tokësore dhe qëndrimi i saj ndaj tyre? Raportoni mbi pastrimin e minave, si dhe kujdesin për të lënduarit apo të traumatizuarit.
- Në periudhën e pasluftës, çfarë bëhet për të ndihmuar fëmijët: trajtim plagësh/traumash; riatdhesim/ribashkim familjesh; ngritje jetimorësh/shkolle? A marrin fëmijët një pjesë të drejtë të burimeve? Si ndikohen ata nga strategjitë e kompensimit apo sanksionet ekonomike? Flisni me fëmijë refugjatë dhe të zhvendosur brenda vendit si dhe me fëmijët e mbetur jetimë nga konflikti.
- A kanë vuajtur vajzat dhe gratë e reja përdhunim apo forma të tjera abuzimi seksual – nga ushtarë dhe milici 'miqësore'? Sa prej tyre mbetën shtatzanë për pasojë, apo morën sëmundje seksualisht të transmetueshme? Çfarë po bëhet për t'i ndihmuar dhe mbështetur ato? A ka stigmë ndaj këtyre vajzave dhe grave të reja?
- Cilat janë detyrimet e qeverisë suaj ndaj fëmijëve për periudhat e luftës (KKBDF, Konventa e 4t e Gjenevës dhe Protokollet, 1997 Parimet e Kejp Taun)? A ka rekrutim ushtarak të të rinjve nën 18 vjeç? A janë trajnuar/shkolluar ushtria, policia dhe shërbimet e urgjencave se si të mbrojnë fëmijët? Kur lind konflikti, cilat janë rreziqet për fëmijët e armiqve të mundshëm?

Fëmijët dhe konflikti i armatosur

- A keni raportuar se çfarë po bën vendi juaj (apo vendi nga i cili raportoni) për të mbrojtur fëmijët nga ndikimi i luftës dhe pasojat e saj – përfshi ngritjen e spitaleve, jetimoreve, shkollave dhe këshillimit?
- A keni qenë sa më objektivë dhe të saktë që ka qenë e mundur mbi informacionin që raportoni gjatë një konflikti? Kujdesuni të mos bëheni pjesë e 'fabrikës së fjalëve' që fillon pasi shkrepet pushka e parë.
- A bazohet raporti juaj tek fjalët e dëgjuara, sidomos në lidhje me 'fëmijë ushtarë'? A keni kontrolluar që imazhet e ushtarëve fëmijë (të armatosur) të mos jenë sajuar për qëllime propaganda – duke i vënë fëmijët në rrezik të mëtejshëm?
- A e përfshin raporti juaj përvojën faktike të një të riu të përfshirë në konflikt? Dhënia zë një fëmije vendos një lidhje njerëzore me lexuesit/shikuesit/dëgjuesit, por siguria e fëmijës duhet të mbetet jetësore dhe duhet menduar me kujdes për të ruajtur identitetin e fëmijës.
- Jini veçanërisht të matur me përdorimin e pamjve të fëmijëve të zënë në konflikt, çka mund të ketë pasoja për ta: vrasje, stigmë, apo diskriminim. Mbroni identitetin e atyre që kanë përjetuar mizori dhe faktet e të cilëve mund të kërkohen në gjyqë pasuese për krime lufte.
- Aty ku është e përshtatshme, përpiquni të siguronit që personave përvojat e të cilëve po përpiqeni të përcillni t'u jepet dinjteti që meritojnë. Identifikojini dhe ofroni edhe një kontekst aty ku mundeni; por respektoni dëshirën e tyre për të mbetur anonimë. Shmangni shndërrimin e fëmijëve në 'ikona të vuajtjes.'

Shëndeti dhe mirëqenia e fëmijëve

- Mbani sytë hapur për raporte dhe statistika zyrtare mbi shëndetin e fëmijëve në vendin tuaj. Për shembull, nivelin e vdekshmërisë në lindje, vdekjet përpara moshës 5 vjeç, dhe nivelet e sëmundjeve të parandalueshme të fëmijërisë të tilla si tuberkulozi dhe difteria. Kërkoni shpjegime nga ekspertë të njohur. Gjurmoni modele diskriminimi në statistika.
- Investigoni epidemitë e fëmijërisë dhe shkaqet e tyre, përfshi çështjet mjedisore dhe ndikimin/mjaftueshmërinë e shërbimeve shtetërore të shëndetit. A ka programe imunizimi masiv? Si e menaxhon shteti kujdesin shëndetësor për fëmijët? Krahasoni nivelet e financimit me shërbime të tjera publike.
- Përdorni reportazhe 'interesi njerëzor' për të eksploruar shërbimet e maternitetit dhe pediatriisë. A ka shpeshësi të lartë të problemeve në lindje? Sa efçente dhe dashamirëse ndaj fëmijëve janë shërbimet spitalore për fëmijët? Investigoni ofrimin e trajtimeve të përparuara për fëmijë, si për shembull transplant i palcës së kockave për leuçemi. A ka lista të gjata pritjeje për operacione të domosdoshme?
- Si është trajtimi dhe përkujdesja ndaj fëmijëve me HIV/SIDA? Çfarë sistemesh mbështetëse ekzistojnë? Investigoni efektshmërinë e fushatave për edukimin shëndetësor për të ndihmuar fëmijët të marrin vendime të informuara mbi jetët e tyre, sidomos në lidhje me dietën dhe sjelljen seksuale.
- Investigoni mjedisin në të cilin jetojnë, mësojnë dhe luajnë fëmijët. Çfarë bëhet (në shkollë, për shembull) për të përmirësuar ndërgjegjësimin mbi stile të shëndetshme jetese (dieta, droga, ndotja, argëtimi, siguria në rrugë, sjellja seksuale, duhanpirja, sportet)?

Shëndeti dhe mirëqenia e fëmijëve

- A është kryer kërkim shterrues dhe a është i saktë raporti juaj? 'Raportet e frikës' për shëndetin të pabazuara mund të bëjnë më shumë dëm se sa të mirë, duke nxitur mosbesim të pajustificuar për profesionistët mjekësorë, për shembull, si edhe për median – madje edhe duke shkaktuar panik publik.
- A i keni përdorur Udhëzimet e Organizatës Botërore të Shëndetit për gazetarët në mbulimin e raporteve për shëndetin? (Shih Shtojcën 5)
- A do t'i ndihmojë mbulimi juaj njerëzit për të kuptuar sëmundjet e fëmijërisë, masat parandaluese dhe procedurat e trajtimit? A keni identifikuar burime për informacion dhe ndihmë mbi kushtet specifike mjekësore në lajme?
- A keni marrë informacion të mjaftueshëm dhe të besueshëm nga autoritetet? A ndihmon raporti juaj që njerëzit të kuptojnë raportet dhe statistikat mbi shëndetin e fëmijëve?
- Nëse po kërkoni të rrisni ndërgjegjësimin e të rinjve mbi HIV/SIDA-n, a keni përfshirë tregimet e vetë atyre mbi vendimet me të cilat përballen, si dhe një informacion të qartë mbi 'seksin e sigurt,' mospërdorimin e përbashkët të gjilpërave dhe masa të tjera parandaluese?
- A inkurajon materiali juaj mirëkuptimin apo nxit paragjykim mbi sëmundjet dhe kushtet (të tilla si HIV/SIDA)? Mbulimi i drejtpeshuar dhe i mirëinformuar mund të ushtrojë trysni mbi autoritetet që ato të ofrojnë trajtimin më të mirë të mundshëm.

Identiteti i fëmijës

- Raportoni në mënyrë analitike mbi ligjet e kombësisë të vendit tuaj dhe ndikimin e tyre mbi fëmijët. Kur dhe si mundën fëmijët të marrin vendime autonome mbi kombësinë e tyre të parapëlqyer? Si i marrin emrat? A kanë emrat e tyre kuptime të veçanta? Çfarë regjistrash zyrtarë mbahen mbi jetët e tyre dhe a mund të kenë akses fëmijët apo prindërit e tyre ndaj këtyre regjistrave? Në çfarë kushtesh mund të korrigjojnë gabime apo të ndryshojnë emrin?
- Investigoni sistemet formale dhe informale të adoptimit dhe vendosjes nën kujdes. A mbrojnë apo diskriminojnë kundrejt identitetit kombëtar, etnik dhe fetar të një fëmije? Shqyrtoni të drejtat dhe problemet e identitetit për fëmijët jetimë, të zhvendosur, të vendosur nën kujdestari, apo të adoptuar. A kanë të drejtë të kenë akses ndaj të gjithë informacionit që është në dispozicion mbi origjinën e tyre? A mund të vendosin origjinën e tyre prindërore – me anë të testeve gjenetike apo mjeteve të tjera? A mund të flasin lirisht me median?
- Deri në ç'masë mund të shijojnë fëmijët kulturën, fenë dhe gjuhën që parapëlqejnë? A njihen dhe mbahen nga shteti shkollat për pakicat? Si operojnë dhe çfarë kanë ato 'të ndryshme'? A e ndjekin fëmijët shkollën me miratimin e tyre apo për shkak të trysnisë së komunitetit? A mund të transferohen mes shkollave kryesore dhe atyre të pakicave?
- Raportoni objektivist mbi grupet që ekzistojnë për të ringritur identitete në rrezik pakësimi apo zhdukjeje. Çfarë ndikimi kanë ato mbi fëmijët e përfshirë dhe çfarë roli luajnë fëmijët në to?
- Investigoni organizatat e huaja që kërkojnë të tërheqin të rinjtë larg kulturave vendore. Cilat janë motivet e tyre? Si financohen?

Identiteti i fëmijës

- Si e keni regjistruar identitetin e fëmijës në raportimin tuaj? A u konsultuat me fëmijët dhe prindërit e tyre se si dëshirojnë të përshkruhen?
- A keni qenë të drejtë dhe paanshëm në mbulimin e raporteve mbi fëmijë apo prindërit e tyre që sfidojnë shtetin në çështje identiteti – si e drejta për të praktikuar fenë që zgjedhin, apo për të mbrojtur vlerat e veta kulturore?
- Kur raportoni pretendime mbi synimet politike të grupeve kulturore apo të pakicave, a keni marrë parasysh pikëpamjet dhe motivet e të gjitha palëve të përfshira, dhe sidomos ndikimin e debatit mbi jetët e fëmijëve përkatës? Prodhimi i raporteve nga perspektiva e fëmijëve mund të jetë një mënyrë ndriçuese për shqyrtimin e çështjeve të tilla problematike.
- A ka gjasa që raporti juaj të nxisë diskriminim ose urrejtje, apo ka më shumë gjasa të shkaktojë mirëkuptim dhe përshtatje mes grupeve të ndryshme etnike, kulturore apo fetare? A i shërben raporti juaj interesave më të mirë të fëmijës – sigurisë dhe ruajtjes së tyre? A paraqitet raporti në mënyrë racionale dhe të drejtpeshuar?
- Kur prodhoni material mbi fëmijë nga grupe pakicash me gjuhën e tyre, çfarë përpjekjesh janë bërë për të siguruar që e kuptojnë atë çka thuhet mbi ta? Për shembull përkthime/titra/ndarje materialesh me botime në 'gjuhën e nënës.'

Opinionet dhe liritë civile të fëmijëve

- Përfshini fëmijët dhe të rinjtë kur kërkoni opinione mbi politikat vendore dhe kombëtare qeveritare. Publikoni pikëpamjet e tyre, sidomos mbi mirëqenien, projekte arsimore apo infrastrukture që i prekin drejtpërdrejt në pikëpamjen afatshkurtër. Nxitini ata të shprehin opinionet e tyre mbi planet për të ardhmen.
- Investigoni aksesin e fëmijëve ndaj informacionit, përfshi arsytet për kufizimet mbi aksesin e tyre ndaj materialeve. Sa e lehtë është që fëmijët të marrin filma, botime, apo lojra që përmbajnë dhunë, apo ato që janë seksualisht specifike? Në çfarë pike shndërrohet rendja pas mbrojtjes së fëmijëve nga lëndimi në censurë të pajustificueshme?
- A kanë shkollat orë mësimi mbi qytetarinë dhe se si funksionon procesi politik? Si e vënë në përdorim fëmijët të drejtën e tyre për të shprehur opinionet e tyre – për shembull, duke prodhuar botimet e tyre, duke bërë filma, duke përdorur internetin, duke mbajtur ditare të fshehta, duke kryer zgjedhje të simuluar, etj?
- Investigoni se çfarë u ndodh të rinjve nëse ata refuzojnë të përmbushin një detyrim ligjor për të marrë pjesë në ushtri apo në forma të tjera shërbimi publik. A mund të jenë të rinjtë nën 18 vjeç kundërshtues të ndërgjegjshëm?
- Investigoni të drejtat e fëmijëve për lirinë e shoqatave dhe grumbullimit paqësor. Raportoni mbi fëmijët që e vënë në përdorim këtë të drejtë. Sigurohuni që ata të kenë mundësi të shprehën për veten e tyre.
- Prodhoni reportazhe mbi klubet e rinisë dhe shoqatat e tjera për të rinjtë, sidomos nëse drejtohen nga fëmijët. Si dhe pse u krijuan? Si funksionojnë? Si financohen? Çfarë vështirësish kanë hasur?

Opinionet dhe liritë civile të fëmijëve

- A mund t'i ndihmojë botimi/programi juaj fëmijët për të shprehur opinionet e tyre, dhe të kontaktojë të tjerë që kanë të njëjtat pikëpamje, interesa dhe aspirata?
- A e shfrytëzojnë raportimet tuaja dobësinë e fëmijëve apo përpiqen të imponojnë mbi ta vlera dhe qendrime të cilat ata mund të mos i kuptojnë?
- A ka shqyrtuar botimi/programi juaj mënyra për të ilustruar diversitetin kulturor mes fëmijëve – nëpërmjet shkruesve/ prezantuesve të ftuar, konkurimeve apo aktiviteteve të sponsorizuara, për shembull?
- A u ka dhënë botimi/programi juaj pasqyrim atyre (përfshi fëmijët dhe të rinjtë) që promovojnë të drejtat dhe opinionet e fëmijëve?
- A keni mbuluar raportime mbi fëmijë që organizohen vetë – përfshi këshillat e shkollave, grupet e fëmijëve të rrugës, sindikatat dhe grupet e fushatave si dhe klube kushtuar arteve, sporteve dhe argëtimeve, apo sipërmarrjeve (tregtare/artistike)?
- Kur raportoni mbi protestat e fëmijëve, a jeni siguruar që nuk po i ekspozoni fëmijët e përfshirë ndaj rreziqeve të burgimit, dhunës apo formave të tjera të ndëshkimit?
- A keni raportuar mbi ndikimin e fëmijëve që ngrenë zërin – për shembull, mbështetjen që kanë përftuar, ndryshimet që kanë mundur të arrijnë, reagimet e figurave publike?
- Keni vizituar faqe interneti ku fëmijët shprehin opinionet e tyre (për shembull: www.unicef.org/voy)?

Fëmijët në kujdesin publik

- Çfarë po bëhet për të përmirësuar kushtet në institucionet ku fëmijët jetojnë dhe mësojnë? A është prirja drejt njësisve më të vogla e më intime të banimit? Si trajtohen dhe monitorohen stafet? A është i ndaluar ndëshkimi fizik, dhe a vihet efektivisht në zbatim? Si kontrollohet dhe parandalohet abuzimi në shtëpitë e fëmijëve? A kanë fëmijët një mjet të sigurtë për të bërë ankesa e për të ngritur shqetësime mbi të gjitha aspektet e jetës të tyre? A ka sisteme të efektshme dhe të pavarura investigimi dhe ndjekjeje të mbarëvajtjes?
- Sa fëmijë janë nën kujdesin publik dhe pse? Sa të besueshme janë shifrat? Sa fëmijë janë të adoptuar/vënë nën përkujdesje familjesh? A largohen shumë prej tyre? Çfarë u ndodh kur rriten përtej moshës së kujdesit publik (perspektiva akademike/e punësimit, jetëgjatësia)? Flisni me ata që kanë kaluar nëpër sistemin e kujdesit rezidencial. Ku janë tani? Si ka ndikuar përvoja e tyre mbi jetën e tyre? Si mendojnë se mund të përmirësohen gjërat?
- Çfarë ndodh me adoptimin dhe vendosjen nën përkujdesje në vendin tuaj? A merren parasysh pikëpamjet dhe të drejtat e fëmijëve? A jetojnë fëmijët e adoptuar/nën përkujdesje me paaftësi me fëmijë pa paaftësi fizike? Mbulimi nga media mund të ndihmojë në përmirësimin e sistemeve dhe ndërgjegjësimin publik, sidomos aty ku informacioni është i kufizuar apo i pabesueshëm.
- A është i rregulluar apo monitoruar transferimi i fëmijëve në një vend tjetër për adoptim? Çfarë zgjedhesh u jepën fëmijëve? Si mbrohen nga abuzimi dhe shfrytëzimi? A janë të gatshëm të përshkruajnë jetën e re fëmijët që janë marrë nga shtëpitë? A pendohen prindërit që kanë dhënë një fëmijë për adoptim? A u është bërë ndonjë rreng? A kanë qenë në gjendje të qëndrojnë në kontakt me fëmijën e tyre?

Fëmijët në kujdesin publik

- A ndihmon raportimi juaj për të shpjeguar se si funksionon sistemi i kujdesit rezidencial? A është e qartë se çfarë të drejtash ligjore kanë fëmijët (dhe prindërit e tyre) për të sfiduar sistemin?
- A keni bërë pyetje të mjaftueshme për të përcaktuar se pse dhe si fëmijët kanë arritur të jenë nën kujdes? Nëse fëmijët janë braktisur dhe/ose sjellë në kundravajtje, nuk është domosdoshmërisht faji i tyre.
- A keni përfshirë 'kënde' pozitive për të shmangur largimin e publikut nga vështirësitë e fëmijëve të braktisur dhe përhapjen e stereotipeve negative? A identifikon apo merr në mbrojtje raportimi juaj fëmijë që janë në rrezik dhe i zbulon ata hapur përpara antipatisë publike?
- A keni raportuar mbi mundësi për fëmijët nën kujdesin publik që të përfshihen në klube dhe të vendosin lidhje me të rinj të tjerë? Raportimi pozitiv mbi mundësitë për fëmijët nën kujdes që të riintegrohen në shoqërinë kryesore mund të ndihmojë uljen e injorancës dhe paragjytimeve.
- A keni bërë maksimumin e mundësive për t'u dhënë fëmijëve nën kujdesin publik një prani dhe një zë në media?
- A keni përfshirë informacion mbi organizatat që mund të ndihmojnë të rinjtë që përballen me vështirësi në shtëpi apo institucione? A ka organizata që specializohen në asistencën për fëmijët e rritur larg prindërve të tyre biologjikë? A keni kontrolluar kredencialet e grupeve që pretendojnë të mbështesin ata që përpiqen të gjurmojnë origjinën e tyre?

Fëmijët dhe media

- Vizitoni shkolla / klube rinore për të folur me fëmijët mbi punën tuaj.
- Pyesni nëse ata kanë të njëjtat mendime si fëmijët anembanë botës që nuk u pëlqen mënyra si paraqiten në media dhe prej medias:
 - të trajtohen si shaka apo të shtyhen për të 'luajtur' si kafshë;
 - përdorimi i imazheve 'të lezetshme' apo shqetësuese thjesht për të evokuar përgjigje emocionale;
 - të 'nxirren' si injorantë apo t'u flitet si të vegjël, apo të rritur që flasin në emër të tyre edhe kur ata vetë kanë dijeni mbi një temë;
 - të trajtohen si grupe homogjene në vend që të trajtohen si individë dhe përdorimi i 'nën-njëzetëvjeçarëve,' 'adoleshentëve' apo 'të rinjve' për të nënkuptuar probleme/telashe.*

* *BURIMI: Intervistimi i Fëmijëve: udhëzues për gazetarë dhe të tjerë,*
Sarah McCrum & Lotte Hughes, Save the Children UK,
1998, ISBN 1 899120 71 8

- Flisni me fëmijë nga grupe të ndryshme shoqërore dhe etnike. Mund të jenë burime të shkëlqyera për raportime dhe ofrojnë vështrime të freskëta mbi tema që i prekin ata drejtpërdrejt: arsimi, shëndeti, loja, kultura, politika, rënia në qafë dhe forma të tjera abuzimi.
- Monitoroni veprimtaritë e Ministrisë/Avokatit të Fëmijëve që merren me çështje të fëmijëve. A ndjejnë fëmijët se këta i përfaqësojnë në mënyrë të mjaftueshme? Kontaktoni organizata joqeveritare që mund të jenë në gjendje t'ju vënë në kontakt me të rinj që kanë histori interesante për të treguar – por kujtoni që të gjitha këto lloj organizatash kanë axhendat e tyre që duan të promovojnë.
- Investigoni përdorimin nga fëmijët të fotografive dhe teknologjisë së informacionit, internetit, dhomave chat, celularëve, etj. A e dinë si ta mbrojnë veten nga materialet e dëmshme? A kanë përjetuar ndonjëherë përjasje të papërshtatshme prej të rriturve apo organizatave komerciale.

Fëmijët dhe media

- Profesionistët e medias kanë një detyrim për të respektuar të drejtat e njeriut të fëmijëve, në mënyrën se si punojnë dhe se si përfaqësojnë fëmijët. A i qëndron kontrollit puna juaj e përfunduar, si dhe mënyra se si e keni mbledhur informacionin? (Shih Shtojca 4)
- A iu përjashtoi raportit tuaj me një pikëpamje të përcaktuar se si donit që fëmijët të përgjigjeshin? A jeni treguar të drejtë ndaj asaj që fëmijët kanë thënë në fakt – do ta njohin veten në atë që keni botuar, apo mos idetë e tyre janë riiinterpretuar nga këndvështrimi i një të rrituri?
- Kur kryet intervista me fëmijë:
 - a u siguruat që ata të ishin të lirshëm dhe jo nën trynë?
 - a lejuat kohë të mjaftueshme për të shpjeguar qëllimet tuaja?
 - a morët pëlqimin e tyre për të përdorur emrat e tyre dhe për të nxjerrë dhe botuar imazhin e tyre?
 - a u siguruat që ata të dinë si t'ju kontaktojnë dhe të marrin një kopje të materialit të përfunduar?
- A e keni vlerësuar rrezikun që ka për fëmijën përdorimi i emrit apo imazhit të tij/saj dhe a e keni diskutuar këtë me fëmijën, prindërit apo kujdestarin e fëmijës, si dhe me kolegë të redaksisë?
- A keni aplikuar të njëjtat procedura kontrolli si ç'do bënit me informuesit e rritur, përpara se të botoni pretendime apo pohime që ju janë bërë nga fëmijët?
- A është marrë botimi/programi juaj me ofrimin e mbështetjes apo këshillave të besueshme/konfidenciale për fëmijët që iu përgjigjen çështjeve që kanë të bëjnë me shëndetin personal, abuzimin fizik apo seksual, shfrytëzimin komercial, apo forma të tjera veprimtarie kriminale?

Fëmijët në media

- Masmedia ka një ndikim të kudogjendur mbi të gjithë jetët tona. Profesionistët e medias mund të kontribuojnë për të përmirësuar 'alfabetizmin për median' mes fëmijëve, si dhe të rriturve, duke shpjeguar se si funksionon masmedia dhe si të interpretohen mesazhet e saj.
- Është e rëndësishme të planifikohet me kujdes për përfshirjen e fëmijëve në të gjitha format e prodhimit për median në mënyrë që kushdo të kuptojë se çfarë mund dhe nuk mund të bëhet. Nëse kompania juaj dëshiron të nxisë fëmijët që të kontribuojnë, ajo duhet të caktojë një këshilltar specialist/korrespondent/redaktor fëmijësh për të përaktuar rregullat e punës: praktika të sigurta pune dhe sisteme monitorimi; trajnimin e mbikqyrësve; udhëzime formale për 'gazetarët e rinj'; dhe udhëzime mbi kontrollin editorial. Rekrutimi prej klubeve të gazetarëve të rinj, anëtarët e të cilëve kanë dhunti në përdorimin e teknologjisë së informacionit, është një pikënisje ideale.
- Nëse fëmijët do të jenë të pranishëm në vendin e punës, kompania duhet të marrë pëlqimin me shkrim prej prindërve/kujdestarëve të tyre, si dhe të ketë mjedise të përshtatshme për mbikqyrëset, ndihmën e parë, periudha pushimi, pije freskuese, si dhe transport të sigurtë nga shtëpia dhe për në shtëpi.
- Prezantojini të rinjtë me teknikat bazë të gazetarisë dhe rregullat që ndikojnë prodhimin në media. Jepuni mundësinë për të vendosur se me cilat tema duan të merren.
- Si mund të kontribuonit ju apo kompania juaj për Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve për Transmetimin (ICDB). Hollësi për ICDB dhe të tjera 'Veprimtari dhe Ide të Mira për Median nga, me dhe për Fëmijë (MAGIC) anembanë botës, mund të gjenden në adresën www.unicef.org/magic. Aty ka lidhje me një rrjet global profesionistësh të medias dhe entuziastësh të rinj për median, si dhe me Rrjetin e Medias së të Rinjve për Europën dhe Azinë Qendrore.

Fëmijët dhe media

- A keni marrë parasysh ju apo kompania juaj si rreziqet fizike ashtu edhe ato psikologjike të përfshirjes së fëmijëve në projektet e medias? Hartoni procedura, udhëzues dhe sisteme monitorimi për të mbrojtur fëmijët nga lëndimi kur janë duke punuar me ju – masa kujdestarie, shëndeti dhe sigurie.
- A jeni të sigurt që projekti juaj nuk po i shfrytëzon fëmijët për qëllime komerciale?
- A ka pasur planifikim dhe trajnim të mjaftueshëm si të stafit ashtu edhe të fëmijëve për të siguruar që fëmijët të kuptojnë se çfarë mund të bëjnë dhe çfarë jo? A janë në dijeni të rregullave që kanë vlerë për median? A kanë një këshillues nga i cili mund të marrin këshilla ekspertësh?
- Për të shmangur pakënaqësi, çorientim dhe pritshmëri të gabuara, a keni negociuar rregulla të qarta me fëmijët në lidhje me përmasat e kontrollit të tyre editorial? A janë mbikqyrësit e tyre realistë mbi çfarë mund të arrijnë fëmijët dhe çfarë mund të bëjnë më pas?
- Çfarë sistemesh vlerësimi janë vendosur me qëllim që të rinjtë të mund të marrin komente mbi punën e tyre? A janë pyetur se çfarë mendojnë dhe a janë të informuar mbi reagimet e audiencës.
- A keni dijeni mbi 'Manifesti i Radios' zhvilluar nga transmetues të rinj nga e gjithë bota? (Shihni www.worldradioforum.org.) A e dini që çdo tre vjet zhvillohet një Samit Botëror mbi Median për Fëmijët dhe Adoloshentët? (Shihni www.childrensmediasummit.com.) A keni dijeni mbi Shoqatën Botërore të Programeve të Gazetave për Lexues të Rinj? (Shihni www.wan-press.org.)

Arsimi

- Investigoni përmbajtjen reale të mundësive të barabarta për të gjithë fëmijët brenda sistemit të arsimit: për shembull, djem dhe vajza; fshatarë dhe qytetarë; ata me paaftësi dhe anëtarët e komuniteteve të pakicave.
- A munden nxënësit që të ndikojnë mbi rregullat dhe procedurat e disiplinës nëpërmjet këshillave të shkollave? A mund të zgjedhin fëmijët se çfarë orësh mësimi të ndjekin? Zbuloni nëse dhe si prindërit mund të ndikojnë në programin mësimor dhe shërbimet arsimore. Çfarë roli kanë ata në menaxhimin e shkollave?
- Krahasoni tipet e ndryshme të sistemeve të ndryshme arsimore – parashkollore, fillore dhe nëntë-vjeçare, shtetërore dhe private. A humbin disa fëmijë sepse tarifat për shërbimet arsimore janë tepër të larta?
- Shikoni raportet mësues/nxënës. Çfarë dallimi sjell përmasa e klasës? Çfarë burimesh ka në dispozicion për mësuesit? A kanë fëmijët akses ndaj pajisjeve të fundit? Investigoni sigurinë e ndërtesave të shkollave.
- A lejohen përjasjet 'alternative' ndaj arsimit? Si janë metodat e mësimdhënies, ndjekja e mësimit, disiplina dhe rezultatet në krahasim me shkollat kryesore?
- Si përballen shkollat me fëmijët 'e prapë'? A vazhdon të përdoret ndëshkimi fizik nga mësuesit? Kur përjashtohet apo dëbohet nga shkolla, a kanë fëmijët të drejtë të apelojnë? Çfarë ndodh me ta më pas? Si përballen shkollat me ngacmimet prej të rriturish? A ka probleme me dhunën kundër mësuesit dhe, nëse po, cilat janë shkaqet?

Arsimi

- A jeni i familjarizuar me mënyrën se si shërbimi arsimor i vendit tuaj duhet të funksionojë? A e keni vënë veten në dijeni të problemeve, ndryshimeve apo nismave pozitive në sistemin arsimor duke vizituar institucionet arsimore?
- A ka botimi apo kompania juaj e transmetimit një njësi të posaçme për arsimin? Kur i prodhon materialet që publikohen – reporterë specialistë, specialistë arsimorë, mësues? Si nxiten fëmijët dhe të rinjtë që të kontribuojnë?
- A e përfshijnë raportimet tuaja mbi arsimin perspektivën e nxënësve si dhe atë të kryemësuesve dhe menaxherëve? A keni marrë komente nga prindër, guvernatorë shkollash, mësues dhe sindikata të tyre?
- A jeni siguruar që fëmijët të jenë në dijeni se mund të citohen dhe a keni kontrolluar që raportimi juaj nuk do t'u shkaktojë probleme për të cilat mund të mos kishin menduar?
- Çfarë mund të bëni për të ndihmuar fëmijët të kuptojnë rolin e medias në shoqëri? A ka shqyrtuar kompania juaj e medias mënyra për të prodhuar informacion në forma të aksesueshme që mund të tërheqin fëmijët madje edhe të ndihmojnë mësuesit në punën e tyre me fëmijët?
- Si e përdor organizata juaj e medias internetin? A ka investiguar ajo mënyrat e përdorimit të rrjetit mbarëbotëror nga fëmijët? A prodhon materiale që fëmijët do të donin ta kishin elektronikisht? A ka shqyrtuar mënyra pozitive për të angazhuar të rinj në raporte, çështje të ditës dhe prodhime të medias duke zhvilluar lidhje interaktive me shkolla?

Fëmijët dhe krimi

- Mbjajni raportimet mbi fëmijët dhe krimin në perspektivë. Të rinjtë kanë më shumë gjasa të jenë viktimë se sa autorë krimesh. Theksioni historitë njerëzore prapa statistikave. Ndërgjegjësoni fëmijët për mënyrat në të cilat mund të mbrojnë veten nga lëndimi.
- A i trajton ligji fëmijët dhe të rinjtë ndryshe nga të rriturit? Si perceptohen dhe trajtohen viktimat e reja të krimin? Si mbrohen dhe monitorohen të drejtat e kundravajtësve apo të dyshuarve të rinj? A trainohen gjyqtarët, avokatët, policët dhe rojet e burgjeve mbi të drejtat e fëmijëve? A kanë fëmijët më shumë apo më pak gjasa të besohen se sa të rriturit?
- Si e perceptojnë fëmijët policinë? Si i trajton policia fëmijët, sidomos fëmijët pa shtëpi dhe ata që arrestojnë?
- Investigoni kufizimet mbi raportimin e medias mbi fëmijët në sistemin e drejtësisë: çështje në gjykata, paraburgim dhe kujdesin pas. A janë të përshtatshme? A ka ligje për të parandaluar mosnxjerrjen e emrave të fëmijëve që akuzohen se kanë shkelur ligjin?
- A përqëndrohet sistemi i drejtësisë tek rehabilitimi apo tek ndëshkimi? A vazhdon të përdoret ndëshkimi fizik brenda institucioneve apo si dënim për një krim? Investigoni numrin dhe kushtet e fëmijëve në të gjitha format e përkujdesjes dhe qëndrimit në institucione dënimi. A përdoren dënimet e vënies në kujdestari vetëm si një alternativë e fundit? A janë shërbimet e periudhave të provës dhe rehabilitimit për fëmijët të mjaftueshme dhe të efektshme?
- Investigoni përdorimin e drogave mes fëmijëve. Pse i përdorin drogat? A është e lehtë të merren droga të rrezikshme? A penalizohen për përdorimin e tyre nëpërmjet terapisë dhe rehabilitimit? A kryhet konsultim me ta mbi stilin dhe përmbajtjen e edukimit mbi drogat dhe shërbimet e rehabilitimit?

Fëmijët dhe krimi

- Sjelljet e dhunshme dhe anti-shoqërore nga fëmijët i kanë burimet gjithmonë tek dhuna dhe qëndrimet e të rriturve ndaj tyre. A nënkupton raportimi juaj që kundravajtësit e rinj meritojnë më pak të drejta se sa të tjerët?
- A keni shmangur përdorimin e panevojshëm të emrave dhe pamjeve të kundravajtësve të rinj? Identifikimi i panevojshëm mund t'i vendosë ata në rrezik të mëtejshëm, duke i bërë famëkeqë, për shembull, dhe duke ulur mundësitë e tyre për rehabilitim. Është gjithashtu edhe një mohim i të drejtave të tyre.
- A jeni siguruar që fëmijëve që janë subjekt akuzash nga publiku apo autoritetet t'u jepet mundësia për t'u përgjigjur? Mos supozoni që fëmijët përfshihen në veprimtari kriminale vetëm sepse janë pa shtëpi.
- A e keni ndjekur raportimin tuaj mbi arrestimin apo akuzimin e fëmijëve? A janë të sigurtë? Nëse janë të ndaluar, si janë kushtet? A mbahen në mjediset e burgimit me fëmijë të tjerë apo me të rritur? A mund të shfrytëzohen shërbime të përshtatshme, të tilla si këshillat ligjore dhe këshillimi?
- A është raportimi juaj mbi drogat dhe abuzimin me drogat i saktë dhe a mbështetet nga fakte shkencore? Pretendimet e rreme dhe sensacionale nuk ndihmojnë prodhimin e strategjive të ndjeshme ndaj abuzuesve të drogave apo dënimin e trafikuesve të drogës. A keni investiguar ata që furnizojnë fëmijët me drogë? Shumë pjesëtarë të publikut mbështeten tek media për informacione bazë – a keni menduar për prodhimin e reportazheve me informacion faktik për fëmijët dhe prindërit mbi efektet e ndryshme të drogave të ndryshme, për shembull, apo procedurat e trajtimit?

Abuzimi dhe shfrytëzimi seksual i fëmijëve

- Raportoni mbi edukimin seksual dhe ligjet që mbulojnë veprimtari seksuale që përfshijnë fëmijë. Si arrihet mosha e pëlqimit për veprimtari seksuale?
- Investigoni abuzimin dhe shfrytëzimin seksual të fëmijëve dhe tabutë që i rrethojnë këto. Shfrytëzoni të dhënat nga vende të tjera mbi përmasat e abuzimit seksual brenda familjeve. A mblihen dhe botohen të dhëna të sakta? A kanë mundësi të gjithë fëmijët (përfshi ata me paaftësi dhe të ndaluarit) që të paraqesin në mënyrë të sigurtë ankesa mbi abuzimin brenda familjes së vet, shkollës apo institucionit? Si trajtohet policia, punonjësit socialë, mësuesit dhe stafi mjekësor për t'u marrë me ta? Si rregullohet konfidencialiteti, mbrojtja, mbështetja dhe këshillimi për fëmijët?
- A është kundravajtje prodhimi, shpërndarja apo zotërimi i pornografisë së fëmijëve? Investigoni efikasitetin e masave për parandalimin e abuzimit dhe prostitucionit të fëmijëve dhe mbron fëmijët nga pornografia, 'linjat e seksit' në telefon dhe pornografia në internet.
- Raportoni mbi procedurat ligjore nisur nga ankesa të tilla. A kanë mbrojtje dhe mbështetje dëshmitarët fëmijë? A trajtohen si kriminelë apo lëndohen nga procesi i hetimit? A mund të ndiqen penalisht apo të ekstradohen qytetarët apo banorët për abuzimin apo shfrytëzimin seksual të fëmijëve në vende të tjera?
- Kryeni investigime mbi abuzimin seksual të fëmijëve me mbështetje të sigurisë dhe profesionale, si për fëmijët ashtu edhe për reporterët. Siguria e fëmijëve të shfrytëzuar komercialisht apo në familje duhet të mbetet jetësore.
- Tregtia e udhëtimit ka filluar të paralajmërojë publikun mbi abuzimin seksual të fëmijëve nga turistët. A i ndjek penalisht vendi juaj njerëzit që abuzojnë me fëmijë në vende të tjera?

Abuzimi dhe shfrytëzimi seksual i fëmijëve

- A është raportimi juaj mbi abuzimin seksual apo shfrytëzimin seksual komercial të fëmijëve kryekëput i saktë?
- A keni portretizuar fëmijë të abuzuar apo të shfrytëzuar si viktime, kriminelë apo si qenie njerëzore me të drejta dhe dinjitet? A ishte e mundur apo e përshtatshme t'u jepej fëmijëve hapësira për të folur vetë? A mund të zbulojnë fjalët apo pamjet tuaja në mënyrë të paqëllimshme identitetin e fëmijëve të abuzuar? A ofron raportimi juaj informacion mbi sigurimin e aksesit ndaj fëmijëve të prekshëm?
- A ishin dakord fëmijët që të fotografoheshin? A morët edhe pëlqimin e një të rrituri përgjegjës? A ishte i rrituri i pranishëm? A duket se imazhet e përdorura për të ilustruar raportimin tuaj seksualizojnë fëmijët, apo japin përshtypjen se fëmija është një pjesëmarrës i vullnetshëm në abuzim apo shfrytëzim? Çfarë marrëveshjes janë bërë për t'u siguruar që të mos mund të ketë përdorim të papërshtatshëm të imazheve të fëmijëve?
- A e sensacionalizon raportimi juaj 'turizmin e seksit,' pornografinë, apo ndonjë formë tjetër shfrytëzimi të fëmijëve? A jeni siguruar që nuk do të shfaqet në kontekstin e materialit seksualisht të drejtpërdrejtë apo materialit që promovon shërbime seksuale?
- Cili është ndikimi i mundshëm i publikimit mbi fëmijët e përfshirë? A janë ngritur sisteme mbështetjeje për t'i mbrojtur ata? A ka një linjë ndihme konfidenciale për t'u marrë me përgjigje për njerëzit që dëshirojnë të raportojnë shembuj të tjerë abuzimi apo shfrytëzimit? Çfarë mbështetjeje ekziston për reporterët që mund të traumatizohen nga raportime të tilla?

Përgjegjësitë e shtetit

- Si po e zbaton qeveria juaj Konventën mbi të Drejtat e Fëmijëve? A ka përmbushur kërkesën për publikimin e parimeve dhe dispozitave të Konventës? A është e vonuar në paraqitjen e raporteve të veta pranë Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve në Gjenevë? Nëse po, cilat janë arsyet? A ka pasur konsultim me publikun?
- A i është bërë jehonë përgjigjes së Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve? Kur është koha e paraqitjes së Raportit të radhës? Investigoni punën e Komitetit. Intervistoni përfaqësuesin për pjesën tuaj të botës.
- Intervistoni personat përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit të Konventës në vendin tuaj. Informohuni për përparimin (apo mungesën e tij). Pyesni fëmijët se për ç'pyetje duan të marrin përgjigje. Kërkoni premtime zyrtare për politika miqësore ndaj fëmijëve, apo veprime për probleme specifike që prekin fëmijët.
- A ka përfshirë qeveria juaj organizata joqeveritare në përpjekjet e saj për të përmirësuar jetët e fëmijëve? A kanë paraqitur këto organizata komentet e tyre pranë Komitetit për të Drejtat e Fëmijëve? Sa të sakta janë të dhënat që kanë mbledhur dhe a ngrenë pikëpyetje mbi pretendimet e qeverisë?
- Raportoni mbi fushatat në vendin tuaj për të përmirësuar jetët e fëmijëve. Si i shohin fëmijët ato? Krahasoni jetët e tyre tani me fëmijërinë e prindërve të tyre.

Përgjegjësitë e shtetit

- A e përmirësojnë raportimet tuaja të kuptuarit nga publiku të të drejtave të fëmijëve dhe rolin e politikave të qeverisë suaj në promovimin dhe mbrojtjen e tyre?
- Gazetarët janë në pozita ideale për të kërkuar veprim nga shteti që ky të respektojë detyrimet e veta ndërkombëtare. A ka fushata që programi/botimi juaj mund të ndërmarrë për të përmirësuar ndërgjegjësimin mbi Konventën si për publikun ashtu edhe për politikanët?
- A keni folur me ekspertë, aktivistë të të drejtave të njeriut dhe vetë fëmijët për t'u informuar mbi problemet me të cilat fëmijët përballen në vendin tuaj?
- A keni kërkuar shpjegime nga qeveritë vendore dhe qendrore mbi mangësitë në ofrimin e shërbimeve për fëmijët dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre?
- A keni krijuar hapësirë që zërat e fëmijëve të dëgjohen nga qeveria dhe shoqëria civile?
- A keni kontrolluar pretendimet e organizatave joqeveritare dhe keni a keni tërhequr vëmendjen ndaj sukseseve apo çfarëdo mangësish të tyre?
- A keni shqyrtuar mënyra në të cilat organizata juaj e medias mund të bashkëpunonte me organizatat joqeveritare për të prodhuar informacion dhe materiale këshillimore për anëtarë të interesuar të publikut që i përgjigjen reportazheve tuaja?

SHTOJCA 1

Përmbledhja e Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve për gazetarin

Hyrja ripërmend parimet bazë të Kombeve të Bashkuara — sidomos frymën e paqes, dinjitetit, tolerancës, lirisë, barazisë dhe solidaritetit – dhe dispozitat e traktateve dhe proklamatave përkatëse për të drejtat e njeriut.

Nuk ka përmendje specifike të përgjegjësive të gazetarëve, por si qen roje për publikun, profesionistët e medias kanë një rol të posaçëm për të luajtur kur qeveritë shpërfillin detyrimet e tyre ndaj fëmijëve.

1. Përkufizimi i një fëmije marrin parasysh intersat më të Të gjithë njerëzit nën moshën 18 vjeç, përveç kur me ligj mosha madhore arrihet në një moshë më të hershme.

2. Mosdiskriminimi
Të gjitha të drejtat kanë vlerë për të gjithë fëmijët pa përjashtim dhe shteti është i detyruar t'i mbrojë fëmijët nga çfarëdo forme diskriminimi. Shteti nuk duhet të shkelë ndonjë të drejtë dhe duhet të ndërmarrë veprime pozitive për t'i promovuar të gjitha ato.

3. Interesat më të mira të fëmijës
Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijën duhet të

marrin parasysh intersat më të mira të tij apo të saj. Shteti duhet të ofrojë kujdes të përshtatshëm kur prindërit apo persona të tjerë përgjegjës dështojnë ta bëjnë këtë.

4. Zbatimi i të drejtave
Shteti është i detyruar t'i bëjë realitet të drejtat e Konventës.

5. Udhëzimi prindëror dhe kapacitetet në zhvillim të fëmijëve
Shteti ka detyrimin të respektojë të drejtat dhe përgjegjësitë e prindërve apo familjes së zgjeruar për të ofruar drejtim dhe udhëzim të përshtatshëm

për fëmijët në ushtrimin e të drejtave të tyre.

6. Mbijetesa dhe zhvillimi
Fëmija ka një të drejtë të lindur për jetën dhe shteti duhet të sigurojë mbijetesën dhe zhvillimin maksimal të fëmijës

7. Emri dhe kombësia
Çdo fëmijë gëzon të drejtën që të ketë një emër nga lindja dhe t'i jepet një kombësi.

8. Ruajtja e identitetit të fëmijës
Shteti është i detyruar të mbrojë dhe, nëse është e nevojshme, të rivendosë bazat e identitetit të fëmijës (emri, kombësia, lidhjet familjare).

9. Ndarja nga prindërit
Fëmijët kanë të drejtë të jetojnë me prindërit e tyre, përveç kur kjo nuk përputhet me interesat e tyre më të mira; e drejta për të mbajtur kontakt me prindërit nëse ndahet nga njëri prind apo të dy; dhe të drejtën për t'u informuar nga shteti mbi vendndodhjen e prindërve nëse kjo ndarje është rezultat i veprimeve të shtetit.

10. Ribashkimi familjar
Fëmijët dhe prindërit e tyre kanë të drejtën të largohen nga çdo vend dhe të hyjnë në vendin e tyre me qëllim që të ribashkohen apo për të ruajtur marrëdhënien fëmijë/prind.

11. Transferimi i jashtëligjshëm dhe moskthimi
Shteti është i detyruar të përpiqet të parandalojë dhe korrigjojë rrëmbimin apo mbajtjen e fëmijëve në një vend tjetër, nga një prind apo nga një palë e tretë.

12. Opinioni i fëmijës
Fëmijët kanë të drejtë të marrin dhe të bëjnë të ditur informacion dhe të shprehin pikëpamjet e tyre, përveç kur kjo do të shkelte të drejtat e të tjerëve.

14. Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë
Fëmija ka të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, duke iu nënshtruar udhëzimeve të përshtatshme prindërore dhe ligjeve kombëtare.

15. Liria e shoqatave

Fëmija ka të drejtë të takohet me të tjerë dhe të bashkohet apo krijojë shoqata, përveç kur kjo shkel të drejtat e të tjerëve.

16. Mbrojtja e privatësisë

Fëmijët kanë të drejtën e mbrojtjes nga ndërhyrja në privatësinë, familjen, shtëpinë, dhe korrespondencë si dhe nga shpifja/përgojimi.

17. Aksesi ndaj informacionit të përshtatshëm

Media ka për detyrë të përhapë informacion për fëmijët që të ketë përfitim shoqëror, moral, edukues dhe kulturor për ta dhe që respekton origjinën e tyre kulturore. Shteti duhet të marrë masa për të nxitur botimin e materialeve me vlerë për fëmijët dhe të mbrojë fëmijët nga materialet e dëmshme.

18. Përgjegjësitë prindërore

Të dy prindërit së bashku kanë përgjegjësi parësore për rritjen e fëmijëve të tyre dhe shteti duhet t'i mbështesë në këtë detyrë.

19. Mbrojtja nga abuzimi dhe neglizhimi

Shteti është i detyruar t'i mbrojë fëmijët nga të gjitha format e dhunës fizike apo mendore të kryer nga prindërit apo të tjerë përgjegjës për kujdesin e tyre, si dhe të ndërmarrë programe parandaluese dhe trajtimi në këtë drejtim.

20. Mbrojtja e fëmijëve pa familje

Shteti është i detyruar të ofrojë mbrojtje të posaçme për fëmijë të privuar nga mjedisi i tyre familjar dhe të sigurojë që atyre t'u vihen në dispozicion kujdes familjar alternativ i përshtatshëm apo vendosje në institucion, duke marrë parasysh origjinën kulturore të fëmijës.

21. Adoptimi

Në vendet ku adoptimi njihet dhe/ose lejohet, mund të kryhet vetëm në interesin sa më të mirë të fëmijës, me të gjitha mbrojtjet e nevojshme për një fëmijë të caktuar dhe me autorizim nga autoritetet kompetente.

22. Fëmijët refugjatë

Fëmijëve që janë refugjatë apo që kërkojnë status refugjati duhet t'u jepet mbrojtje e posaçme dhe shteti është i detyruar të bashkëpunojë me organizata kompetente që ofrojnë mbrojtje dhe asistencë të tillë.

23. Fëmijët me paaftësi

Fëmijët me paaftësi kanë të drejtë për kujdes, arsim dhe trajnim të posaçëm për t'i ndihmuar të arrijnë vetëmbështetjen dhe pjesëmarrjen më të madhe të mundshme për të bërë një jetë të plotë dhe aktive në shoqëri.

24. Shëndeti dhe shërbimet shëndetësore

Fëmija ka të drejtë për të patur nivelin më të lartë të shëndetit dhe aksesit ndaj shërbimeve mjekësore, me theks të veçantë mbi kujdesin shëndetësor parësor dhe edukimin për shëndetin publik dhe uljen e vdekshmërisë foshnjore. Shteti është i detyruar të punojë për ndalimin e praktikave tradicionale të dëmshme. Vihet

theksi mbi nevojën për bashkëpunim ndërkombëtar për ta siguruar këtë të drejtë.

25. Rivlerësimi periodik i vendosjes

Një fëmijë i vendosur nga shteti për arsye përkujdesjeje, mbrojtjeje apo trajtimi, ka të drejtë që të gjitha aspektet e kësaj vendosjeje të vlerësohen rregullisht.

26. Sigurimet shoqërore

Fëmijët kanë të drejtën të përfitojnë nga sigurimet shoqërore.

27. Standardi i jetesës

Fëmijët kanë të drejtë të përfitojnë nga një standard i mjaftueshëm jetese. Është përgjegjësi parësore e prindërve ta ofrojnë këtë dhe detyra e shtetit të sigurojë që prindërit janë në gjendje ta përmbushin këtë përgjegjësi. Shteti mund të ofrojë mbështetje materiale në rast nevojë, dhe mund të kërkojë të sigurojë mbulimin kostove për mbajtjen e fëmijës nga prindër apo kujdestarë që mungojnë.

28. Arsimi

Fëmija ka të drejtën për arsim dhe shteti ka detyrën të sigurojë që të paktën arsimi fillor të jetë falas dhe i detyrueshëm. Administrimi i disiplinës shkollore duhet të pasqyrojë dinjitetin njerëzor të fëmijës. Theksi vendoset mbi nevojën për bashkëpunim ndërkombëtar për ta siguruar këtë të drejtë.

29. Synimet e arsimit

Shteti duhet të njohë që arsimi duhet të drejtohet në zhvillimin e personalitetit dhe talenteve të fëmijës, duke e përgatitur fëmijën për një jetë aktive si i rritur, duke promovuar respektin për të drejtat bazë të njeriut dhe duke zhvilluar respekt për vlerat kulturore dhe kombëtare të fëmijës dhe të të tjerëve.

30. Fëmijët e pakicave dhe popujve indigjenë

Fëmijët e komuniteteve të pakicave dhe popujve indigjenë kanë të drejtën të shijojnë kulturën e tyre dhe të praktikojnë fenë dhe gjuhën e tyre.

31. Koha e lirë, veprimtaritë argëtuese dhe kulturore

Fëmijët kanë të drejtë për kohë të lirë, lojë dhe pjesëmarrje në veprimtari kulturore dhe artistike.

32. Puna e fëmijëve

Shteti është i detyruar të mbrojë fëmijët nga angazhimi në punë që përbën kërcënim për shëndetin, arsimin apo zhvillimin e tyre, të përcaktojë paga minimale për punësim, si dhe të rregullojë kushtet për punësim.

33. Abuzimi me drogën

Fëmija gëzon të drejtën e mbrojtjes nga përdorimi i drogave narkotike dhe psikotropike dhe nga përfshirja në prodhimin dhe shpërndarjen e tyre.

34. Shfrytëzimi seksual

Fëmija ka të drejtën e mbrojtjes nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual, përfshi prostitucionin dhe përfshirjen në pornografi.

35. Shitja, trafikimi dhe rrëmbimi

Shteti është i detyruar të bëjë çdo përpjekje për të parandaluar shitjen, trafikimin dhe rrëmbimin e fëmijëve.

36. Forma të tjera shfrytëzimi

Fëmija ka të drejtën e mbrojtjes nga të gjitha format e tjera të shfrytëzimit që nuk mbulohen në Nenet 32-35.

37. Tortura dhe privimi i lirisë

Tortura, trajtimi apo ndëshkimi mizor, ndëshkimi kapital, dhe burgosja për jetë ndalohen. Arrestimi dhe çfarëdo forme e kufizimit të lirisë duhet përdorur vetëm si një mjet i fundit dhe për kohën më të shkurtër të përshtatshme. Fëmijët gëzojnë të drejtën për trajtim të përshtatshëm, veçim nga të rritur të ndaluar, kontakte me familjen dhe akses ndaj asistencës ligjore dhe llojeve të tjera.

38. Konfliktet e armatosura

Shtetet janë të detyruara të respektojnë dhe sigurojnë respektim për të drejtën humanitare për sa i përket fëmijëve. Fëmijët nën 15 vjeç

nuk duhet të marrin pjesë drejtpërdrejt në luftime apo të rekrutohen në forcat e armatosura. Të gjithë fëmijët e prekur nga konflikti i armatosur duhet të përfitojnë nga mbrojtja dhe përkujdesja.

39. Kujdesi rehabilitues

Shteti është i detyruar të sigurojë që fëmijët e dëmtuar nga konflikti i armatosur, tortura, neglizhenca, keqtrajtimi apo shfrytëzimi, të marrin trajtim të përshtatshëm për shërimin dhe riintegrimin e tyre shoqëror.

40. Administrimi i drejtësisë për të mitur

Fëmijët e akuzuar apo të njohur se kanë kryer një kundravajtje gëzojnë të drejtën për respektim të të drejtave të tyre të njeriut dhe, në veçanti, për të përfituar nga të gjitha aspektet e procesit të dëgjimit ligjor, përfshi asistencën ligjore apo të llojit tjetër në përgatitjen dhe paraqitjen e mbrojtjes së tyre. Rekursi për procedurat gjyqësore dhe vendosjet

institucionale duhet shmangur kudo ku është e mundur dhe e përshtatshme.

41. Respektimi i standardeve ekzistuese

Nëse ndonjë standard i përcaktuar në ligjin kombëtar apo instrumentet përkatëse ndërkombëtare janë më të larta se sa ato në këtë Konventë, aplikohet standardi më i lartë.

42-54. Reklamimi dhe zbatimi i Konventës

- Shteti është i detyruar të bëjë t'i bëjë të njohura gjerësisht për të rriturit dhe fëmijët të drejtat e përfshira në Konventë.

- Shtetet zgjedhin një Komitet për Të Drejtat e Fëmijës, të përbërë nga 10 ekspertë, i cili shqyrton raportet e paraqitura nga palët për Konventën dy vjet pas ratifikimit dhe çdo pesë vjet më pas.

- Këto raporte i duhen vënë në dispozicion publikut.

- Komiteti mund të propozojë që të ndërmerren studime të posaçme mbi çështje specifike

që lidhen me të drejtat e fëmijës dhe vlerësimet e tyre të bëhen të njohura për Shtetin Palë përkatës si edhe për Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

- Për të promovuar zbatimin e Konventës dhe për të nxitur bashkëpunim ndërkombëtar, organe të tilla si Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), Organizata Botërore e Shëndetit (OBSH), Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara (UNESCO) dhe Fondi për Fëmijët i Kombeve të Bashkuara (UNICEF) nxiten ta këshillojnë Komitetin dhe lejohen të ndjekin takimet e tij.

- Ato mund të paraqesin informacionin përkatës pranë Komitetit dhe t'u kërkohet të japin këshilla mbi zbatimin optimal të Konventës, së bashku me organe të tjera të njohura si kompetente – përfshi organe të tjera të Kombeve të Bashkuara dhe OJQ që kanë status konsultativ me Kombet e Bashkuara.

PËR TEKSTE TË PLOTA

KKBDF në anglisht:
www.ohchr.org/English/law/crc.htm

KKBDF në 38 gjuhë:
www.unicef.org/magic

Protokolli Opsional mbi prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë e fëmijëve:
www.ohchr.org/English/law/crc-sale.htm

Protokolli Opsional mbi përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura: www.ohchr.org/English/law/crc-conflict.htm

Protokolli i Palermos kundër trafikimit:
www.ohchr.org/English/law/protocol/traffic.htm

SHTOJCA 2

Objektivat e Mijëvjeçarit të Kombeve të Bashkuara

191 shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara kanë nënshkruar Objektivat e Mijëvjeçarit, të cilat lidhen ngushtë me Konventën e Kombeve të Bashkuara për Të Drejtat e Fëmijëve. Shqyrtimi i përparimit drejt objektivave që kanë përcaktuar vetë shtetet mund të prodhonte raportime interesante dhe informuese. OKB ka botuar hollësi të mënyrave në të cilat arrijtjet mund të maten nga secili vend.

1. Çrrenjosja e varfërisë ekstreme dhe e urisë

- Duke përgjysmuar, midis viteve 1990 dhe 2015, përqindjen e njerëzve të ardhurat e të cilëve janë më pak se një dollar në ditë, si dhe përqindjen e njerëzve që vuajnë nga uria.

2. Arritja e arsimit fillor universal

- Duke siguruar që, deri në vitin 2015, djemtë dhe vajzat, kudo, do të jenë në gjendje të përfundojnë një kurs të plotë shkollimi fillor.

3. Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i gruas

- Duke eliminuar pabarazinë gjinore në arsimin fillor dhe nëntëvjeçar, parapëlqehet deri në vitin 2005, dhe në të gjitha nivelet e arsimit jo më vonë se viti 2015.

4. Ulja e vdekshmërisë së fëmijëve

- Duke ulur me dy të tretat, midis viteve 1990 dhe 2015, përqindjen e vdekshmërisë për moshën nën pesë vjeç.

5. Përmirësimi i shëndetit mëmësor

- Duke ulur me tre të katërtat, midis viteve 1990 dhe 2015, përqindjen e vdekshmërisë mëmësore.

6. Lufta kundër HIV/SIDA, malaries dhe sëmundjeve të tjera

- Ndalimin dhe fillimin e zbrapsjes së përhapjes së HIV/SIDA, si dhe të shfaqjes së malaries dhe sëmundjeve të tjera kryesore, deri në vitin 2015.

7. Sigurimi i qëndrueshmërisë mjedisore

- Duke integruar parimet e zhvillimit të qëndrueshëm në politikat dhe programet e vendeve dhe duke zbrapsur humbjen e burimeve mjedisore;
- Duke përgjysmuar përqindjen e njerëzve pa akses të qëndrueshëm ndaj ujit të pijshëm dhe higjenës bazë, deri në vitin 2015;
- Duke përmirësuar në mënyrë domethënëse jetët e të paktën 100 milion banorëve të zonave shumë të varfra deri në vitin 2020.

8. Zhvillimi i një partneriteti global për zhvillimin

- Duke zhvilluar më tej një sistem tregtie dhe një sistem financiar të hapur, bazuar mbi rregulla, të parashikueshme, dhe mosdiskriminuese (një përkushtim ndaj qeverisjes së mirë, zhvillimit dhe uljes së varfërisë, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar);
- Duke trajtuar nevojat e veçanta të vendeve më pak të zhvilluara. (Akses të çliruar nga tarifat dhe kuotat për eksportet nga vendet më pak të zhvilluara; ndihmë të përforcuar për çlirim nga borxhet për vendet e varfra; anulimin e borxhit zyrtar dypalësh; asistencë më bujare për zhvillimin e vendeve që i janë përkushtuar uljes së varfërisë);
- Duke trajtuar nevojat e veçanta të vendeve në zhvillim në toka të izoluara dhe në ishuj të vegjël;
- Duke ndihmuar për t'i bërë borxhet e vendeve në zhvillim të qëndrueshme nga pikëpamja afatgjatë;
- Duke zhvilluar dhe aplikuar strategji për punë të sigurtë, me rendiment për rininë, në bashkëpunim me vendet në zhvillim;

- Duke ofruar akses ndaj medikamenteve thelbësore në vendet në zhvillim, në bashkëpunim me kompanitë farmaceutike;
- Duke vënë në dispozicion përfitimet e teknologjive të reja, sidomos në informacion dhe komunikacione, në bashkëpunim me sektorin privat.

[Shihni www.un.org/millenniumgoals and http://millenniumindicators.un.org/unsd/mi/mi_goals.asp]

SHTOJCA 3

Një Botë e Përshtatshme për Fëmijët?

Një Sesion i Posaçëm i Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në vitin 2002 adoptoi një Deklaratë, e cila ofron një standard të dobishëm me të cilin mund të maten politikat dhe arritjet e qeverive dhe të tjerëve të përfshirë në mirëqenien e fëmijëve.

1. Fëmijët në radhë të parë

Në të gjitha veprimet që lidhen me fëmijët, interesat më të mira të fëmijëve duhet të marrin konsideratë parësore.

2. Çrrenjosja e varfërisë: investim tek fëmijët

Riafirmojmë betimin tonë për të thyer ciklin e varfërisë brenda një brezi, të bashkuar në besimin që investimet tek fëmijët dhe realizimi i të drejtave të tyre janë mes mënyrave më të efektshme për të çrrenjosur varfërinë. Duhet ndërmarrë veprime të menjëhershme për të eliminuar format më të rënda të punës së fëmijëve.

3. Asnjë fëmijë të mos mbetet pas

Çdo vajzë dhe djalë është lindur e/i lirë dhe e/i barabartë në dinjitet dhe të drejta; për rrjedhojë, të gjitha format e diskriminimit që prekin fëmijët duhet të marrin fund.

4. Kujdes për çdo fëmijë

Fëmijët duhet të kenë fillimin më të mirë të mundshëm në jetë. Mbijetesa, mbrojtja, rritja dhe zhvillimi i tyre me shëndet të mirë dhe me ushqimin e duhur është themeli jetësor i zhvillimit jetësor. Ne do të bëjmë përpjekje të bashkërenduara për të luftuar sëmundjet ngjitëse, për t'u marrë me shkaqet madhore të kequshqimit dhe për t'i ushqyer fëmijët në një mjedis të sigurtë që u jep atyre mundësi të jenë fizikisht të shëndetshëm, mendërisht të vëmendshëm, emocionalisht të sigurtë, shoqërisht kompetentë dhe të aftë për të mësuar.

5. Shkollim për çdo fëmijë

Të gjitha vajzat dhe djemtë duhet të kenë akses dhe të përfundojnë arsimin fillestar falas, të detyrueshëm dhe me cilësi të mirë, si një gur themeli për arsimin përfshirës bazë. Pabarazitë gjinore në arsimin fillor dhe nëntëvjeçar duhet të eliminohen.

6. Mbrojtje fëmijëve nga lëndimi dhe shfrytëzimi

Fëmijët duhet të mbrohen kundër akteve të dhunës, abuzimit, shfrytëzimit dhe diskriminimit, si dhe nga të gjitha format e terrorizmit dhe marrjes së pengjeve.

7. Mbrojtje fëmijëve nga lufta

Fëmijët duhet të mbrohen nga tmerret e konfliktit të armatosur. Fëmijët nën pushtim të huaj duhet të mbrohen, në përputhje me ligjin ndërkombëtar humanitar.

8. Luftë kundër HIV/SIDA

Fëmijët dhe familjet e tyre duhet të mbrohen nga ndikimi shkatërrimtar i virusit të imuno-deficiencës njerëzore/sindroma e imuno-deficiencës së përftuar (HIV/SIDA).

9. Dëgjojmë fëmijët dhe sigurojmë pjesëmarrjen e tyre

Fëmijët dhe adoleshentët janë qytetarë krijues, të aftë për të ndihmuar ndërtimin e një të ardhmeje më të mirë për të gjithë. Duhet të respektojmë të drejtën e tyre për t'u shprehur dhe për të marrë pjesë në të gjitha çështjet që ndikojnë tek ata, në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tyre.

10. Mbrojtje e Tokës për Fëmijët

Duhet të ruajmë mjedisin tonë natyror, me shumëllojshmëri të vetë jetës, bukurinë dhe burimet e tij, të cilat rrisin cilësinë e jetës, për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm. Do të japim çdo

asistencë për të mbrojtur fëmijët dhe për të minimizuar ndikimin e fatkeqësive natyrore dhe degradimit mjedisor mbi ta.

[Shihni: www.unicef.org/specialsession/wffc/index.html]

SHTOJCA 4

Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve Udhëzime dhe Parime për Raportimin mbi Çështje që Përfshijnë Fëmijët

Të gjithë gazetarët dhe profesionistët e medias kanë detyrën të ruajnë standardet më të larta etike dhe profesionale dhe duhet të promovojnë brenda industrisë përhapjen më të gjerë të mundshme të informacionit mbi Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi Të Drejtat e Fëmijëve (KKBDF) dhe implikimet e saj për ushtrimin e gazetarisë së pavarur.

Organizatat e medias duhet ta shohin shkëlqimin e të drejtave të fëmijëve dhe çështjet e lidhura me sigurinë, privatësinë, sigurinë, shkollimin, shëndetin dhe mirëqenien sociale të tyre si dhe të gjitha format e shfrytëzimit si çështje të rëndësishme për investigim dhe debat publik. Fëmijët kanë një të drejtë absolute për privatësi, ku të vetmet përjashtime janë ato të përcaktuara shprehimisht në këto udhëzime.

Veprimtaria gazetareske, e cila prek jetën dhe mirëqenien e fëmijëve, duhet të kryhet gjithmonë me mirëkuptim të situatës së ekspozuar të fëmijëve.

Gazetarët dhe organizatat e medias duhet të bëjnë gjithçka munden për të ruajtur standardet më të larta të sjelljes etike në raportimin mbi çështjet e fëmijëve dhe, në veçanti:

- **do të bëjnë gjithçka munden** për të shkëlqyer për nga saktësia dhe ndjeshmëria kur raportojnë mbi çështje që përfshijnë fëmijë;
- **do të shmangin** programimin dhe publikimin e imazheve që ndërhyjnë në hapësirën e medias së fëmijëve me informacion që është i dëmshëm për ta;

- **do të shmangin** përdorimin e stereotipeve dhe prezantimeve sensacionale për të promovuar materiale gazetareske që përfshijnë fëmijë;
- **do të shqyrtojnë** me kujdes pasojat e publikimit të çfarëdo materiali që ka të bëjë me fëmijë dhe do të minimizojnë lëndimin e fëmijëve;
- **do të ruhen** nga identifikimi pamor apo në forma të tjera i fëmijëve, përveç kur është dukshëm në interesin publik;
- **do t'u japin** fëmijëve, aty ku është e mundur, të drejtën e aksesit ndaj medias për të shprehur opinionet e tyre pa nxitje të ndonjë lloji;
- **do të sigurojnë** verifikimin e pavarur të informacionit të ofruar nga fëmijët dhe do të tregojnë kujdes të posaçëm për të siguruar që verifikimi ndodh pa vënë në rrezik informuesit fëmijë;
- **do të shmangin** përdorimin e imazheve të seksualizuara të fëmijëve;
- **do të përdorin** metoda të drejta, të hapura dhe të drejtpërdrejta për të marrë pamje dhe, aty ku është e mundur, do ta bëjnë këtë me dijeninë dhe pëlqimin e fëmijëve apo një të rrituri përgjegjës apo kujdestari;
- **do të verifikojnë** kredencialet e cilësdo organizatë që pretendon të flasë në emër të interesave të fëmijëve dhe t'i përfaqësojë ato interesa;
- **nuk do të paguajnë** fëmijë për material që ka të bëjë me mirëqenien e fëmijëve apo nuk do të paguajnë prindër apo kujdestarë fëmijësh përveç kur kjo është dukshëm në interes të fëmijës.

Gazetarët duhet të shqyrtojnë në mënyrë kritike raportet e paraqitura dhe pretendimet e ngritura nga qeveritë mbi zbatimin e KKBDF në vendet e tyre respektive.

Media nuk duhet t'i shohë dhe raportojë kushtet e fëmijëve vetëm si ngjarje, por duhet të raportojë në mënyrë të

vazhdueshme procesin që ka gjasa të çojë apo që çon në ndodhjen e këtyre ngjarjeve.

Shpallur në Recife, Brazil në Maj 1998, adoptuar nga Kongresi i FNG në Seul, 2001.

UNICEF ka zhvilluar Udhëzimet e veta Etike për Raportimin mbi Fëmijët?

www.unicef.org/media/media_tools_guidelines.html

SHTOJCA 5

Rrjeti European i Komunikacioneve mbi Shëndetin Udhëzime për Korrespondentët Profesionalistë të Shëndetit

Hartuar në vitin 1998 nga PressWise (MediaWise) dhe zhvilluar gjatë dy viteve në konsultim me komunikues dhe korrespondentë të shëndetit dhe FNG, versioni përfundimtar u adoptua në vitin 2000 nga Rrjeti European i Komunikacioneve mbi Shëndetin, i Organizatës Botërore të Shëndetit si drejtues për praktika të mira.

1. Së pari, përpiquni të mos lëndoni. Të drejtat e njeriut dhe e mira publike kanë rëndësi jetësore.
2. Jini të saktë. Kontrolloni faktet dhe burimet tuaja, edhe nëse rrezikohen afatet.
3. Mos krijoni shpresa të rreme. Jini veçanërisht të kujdesshëm kur raportoni mbi pretendime për 'kura mrekullish' apo mundësi 'paniku për shëndetin.'
4. Tregohuni të kujdesshëm ndaj interesave të fshehura. Pyesni veten, 'kush përfiton më shumë nga ky raportim?'
5. Refuzoni shtysat personale. Gjithmonë bëjeni të qartë nëse materiali po botohet si rezultat i sponsorizimeve.
6. Kurrë mos zbuloni informacion të dhënë në konfidencë.
7. Respektoni privatësinë e të sëmurëve, personave me paaftësi, si dhe familjeve të tyre, në çdo kohë.
8. Jini të vëmendshëm ndaj pasojave të raportit tuaj. Kujtoni që individët që mund të jenë të sëmurë apo me paaftësi – sidomos fëmijët – kanë jetë për të jetuar edhe shumë kohë pasi media të ketë humbur interesin.
9. Kurrë mos ndërhyini në hidhërime private. Respektoni ndjenjat e personave në zi, sidomos kur trajtoni fatkeqësi. Fotografitë apo imazhet televizive nga afër të viktimave apo familjeve të tyre duhen shmangur kurdo që është e mundur.
10. Nëse keni dyshime, mos e përfshini.

SHTOJCA 6

Kalendar 'Pineskash'

Është gjithmonë e dobishme të keni pineska ku të varni ide për raportime. Kjo përzgjedhje aktiviteteve ndërkombëtare ofron disa sugjerime. Do të ketë shumë më tepër përvjetorë dhe aktivitete kombëtare, kulturore dhe fetare përreth të cilave të mund të ndërtoni 'këndin e fëmijëve.'

Mars

- 8 Dita Ndërkombëtare e Gruas
- 21 Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Diskriminimit Racor
- 22 Dita Botërore për Ujin
- 24 Dita Botërore e Tuberkulozit

Prill

- 7 Dita Botërore e Shëndetit

Maj

- 3 Dita Botërore e Lirisë së Shtypit
- 31 Dita Botërore Pa Duhan

Qershor

- 4 Dita Ndërkombëtare e Viktimave Fëmijë të Agresionit
- 12 Dita Botërore Kundër Punës së Fëmijëve
- 26 Dita Ndërkombëtare Kundër Abuzimit dhe Trafikut të Jashtëligjshëm të Drogës
- 26 Dita Ndërkombëtare në Mbështetje të Viktimave të Torturës

Gusht

- 9 Dita Ndërkombëtare për Popujt Indigenë
- 12 Dita Ndërkombëtare e Rinisë

- 23 Dita Ndërkombëtare e Përkujtimit të Zhdukjes së Tregtisë së Skllëvërve

Shtator

- 8 Dita Ndërkombëtare e Alfabetizimit
- 21 Dita Ndërkombëtare e Paqes

Tetor

- 5 Dita Botërore e Mësuesve
- 16 Dita Botërore e Ushqimit
- 24 Dita e Kombeve të Bashkuara

Nëntor

- 20 Dita Botërore e Fëmijëve
- 25 Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës Kundër Gruas

Dhjetor

- 1 Dita Botërore e SIDA-s
- 2 Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Skllavërisë
- 3 Dita Ndërkombëtare për Personat me Paaftësi
- 5 Dita Ndërkombëtare e Vullnetarëve
Dita Ndërkombëtare e Transmetimit e Fëmijëve
- 10 Dita e Të Drejtave të Njeriut
- 18 Dita Ndërkombëtare e Migrantëve

SHTOJCA 7

Kontakte të dobishme ndërkombëtare
Shumë prej këtyre kontakteve kanë zyra kombëtare
apo filiale vendore në çdo vend.

1. Organizata që merren me të drejtat e fëmijëve

Amnesty International

99-119 Rosebery Avenue,
London,
EC1R 4RE, UK
tel +44 20 7814 6200
fax +44 20 7833 1510
email mnestyis@amnesty.org
web www.amnesty.org

Anti-Slavery International

Thomas Clarkson House,
The Stable Yard, Broomgrove
Road, London SW9 9TL, UK
tel +44 20 7501 8920
fax +44 20 7738 4110
email info@antislavery.org
web www.antislavery.org

Centre for the Study of Children, Youth and Media

Institute of Education, London
University, 20 Bedford Way,
London WC1H 0AL, UK
tel +44 207 612 6515
fax +44 207 612 6177
email d.buckingham@ioe.ac.uk
web www.ccsionline.org.uk/mediacentre/main.html

ChildHope

Lector Court, 151 Farringdon
Road, London EC1 3AF, UK
tel +44 207 833 0868
fax +44 207 833 2500
email chuk@gn.apc.org
web www.childhopeuk.org

Children and Armed Conflict Unit

Human Rights Centre, Essex
University, Wivenhoe Park,
Colchester, CO4 3SQ, UK
tel +44 1206 873 483
fax +44 1206 874 026
email armedcon@essex.ac.uk
web www.essex.ac.uk/armedcon

Children's Express Worldwide

Exmouth House, 3-11 Pine
Street,
London EC1R 0JH, UK
tel +44 207 833 2577
fax +44 207 278 7722
email enquiries@childrens-express.org
web www.childrens-express.org

Childwatch International Research Network

P.O. Box 1132 Blindern, N-0317

Oslo, Norway

tel +47 22 85 43 50
fax +47 22 85 50 28
email childwatch@uio.no
web www.childwatch.uio.no

Coalition to Stop the Use of Child Soldiers

2nd floor, 2-12 Pentonville
Road,
London, N1 9FP, UK
tel +44 20 7713 2761
fax +44 20 7713 2794
email info@child-soldiers.org
web www.child-soldiers.org

Committee on the Rights of the Child

c/o Office of the United Nations
High Commissioner for Human
Rights, 8-14 Avenue de la Paix,
1211 Geneva 2, Switzerland
tel +41 22 917 9000
fax +41 22 917 9022
email crc@ohchr.org
web www.unhchr.ch/html/menu2/6/crc

Concerned for Working Children

303/2 L B Shastri Nagar,
Vimanapura Post, Bangalore
560 017, Karnataka, India
tel +91 80 52 34 611
fax +91 80 52 34 258
email cwc@pobox.com
web www.workingchild.org

Defence for Children International

Rue de Varembe 1, CH-1211
Geneva 20, Switzerland
tel +41 22 734 05 58
fax +41 22 740 11 45
email dci-hq@pingnet.ch
web www.defence-forchildren.org

Early Childhood Unit

UNESCO, 7 Place de Fontenoy,
75352 Paris, 07 SP France
tel +33 01 45 68 08 12
fax +33 01 45 68 56 27
email secretariat@unesco.org
web www.unesco.org/education/educprog/ecf

Education International

5, Bd du Roi Albert II (8th floor),
B-1210 Brussels, Belgium
tel +32 2 224 0611
fax +32 2 224 0606
email headoffice@ei-ie.org
web www.ei-ie.org

End Child Prostitution, Child Pornography and the Trafficking of Children for Sexual Purposes

(ECPAT) International
328 Phaya Thai Road, Bangkok
10400, Thailand
tel +662 215 3388
fax +662 215 8272

email info@ecpat.net
web www.ecpat.net

European Council for Refugees and Exiles

103 Worship Street, London,
EC2A
2DF, UK
tel +44 207 377 7556
fax +44 207 377 7586
email ecre@ecre.org
web www.ecre.org

EveryChild

4 Bath Place, Rivington St,
London,
EC2A 3DR, UK
tel +44 207 749 2468
fax +44 207 729 8339
email paul.dimnick@every-child.org.uk
web www.everychild.org.uk

Human Rights Internet

8 York Street, Suite 302,
Ottawa, Ontario K1N 5S6 Canada
tel +1 613 789 7407
fax +1 613 789 7414
email hri@hri.ca
web www.hri.ca

Human Rights Watch - Children's Rights Project

350 Fifth Avenue, 34th Floor, New
York 10118-3299, USA
tel +1 212 290 4700
fax +1 212 736 1300
email hrwnyc@hrw.org
web www.hrw.org/children

International Centre of Films for Children and Young People

3774 St-Denis, Bureau 200,
Montreal QC, Canada H2W 2M1
tel +1 514 284 9388
fax +1 514 284-0168
email info@cifej.com
web www.cifej.com

International Committee of the Red Cross (ICRC)

Public Information Centre, 19
Avenue de la Paix, CH 1202,
Geneva, Switzerland
tel +41 22 734 60 01
fax +41 22 733 20 57
email press.gva@icrc.org
web www.icrc.org

International Confederation of Free Trade Unions (ICFTU)

5 Boulevard du Roi Albert II, Bte 1,
1210-Brussels, Belgium
tel +32 22 24 0211
fax +32 22 01 5815
email internetpo@icftu.org
web www.icftu.org

International Federation of Red Cross and Red Crescent Societies

PO Box 372, CH-1211 Geneva 19,
Switzerland
tel +41 22 730 4222
fax +41 22 733 0395
email secratariaat@ifrc.org
web www.ifrc.org

International Programme on the Elimination of Child Labour (IPEC)

International Labour
Organisation,
4, Route des Morillons, CH-1211
Geneva 22, Switzerland
tel +41 22 799 8181
fax +41 22 799 8771
email ipecc@ilo.org
web www.ilo.org/public

Save the Children Alliance

2nd Floor, Cambridge House,
100 Cambridge Grove, London,
W6 0LE, UK
tel +44 208 748 2554
fax +44 208 237 8000
email burkhard@save-childrenalliance.org
web www.savethe-children.net

International Society for the Prevention of Child Abuse and Neglect (ISPSCAN)

25 W.560 Geneva Road, Suite
L2C, Carol Stream, IL 60188,
USA
tel +1 630 221 1311
fax +1 630 221 1313
email ISPSCAN@ispcan.org
web www.ispcan.org

International Youth Foundation

32 South Side, Suite 500,
Baltimore, MD 21202, USA
tel +1 410 951 1500
fax +1 410 347 1188

email youth@iyfnet.org
web www.iyfnet.org

Medzasi (First Children's Embassy in the World)

Str. 'Kosta Novakovikj' 22a,
1000 Skopje, Macedonia
tel +389 2 46 53 16
fax +389 2 46 39 00
email first@childrensembassy.org.mk
web www.childrensembassy.org.mk

Minority Rights Group International

379 Brixton Road, London,
SW9 7DE, UK
tel +44 207 978 9498
fax +44 207 738 6265
email minority.rights@mrgmail.org
web www.minorityrights.org

Street Kids International

38 Camden Street, Suite 201,
Toronto M5V 1V1, Canada
tel +1 416 504 8994
fax +1 416 504 8977
email ski@streetkids.org
web www.streetkids.org

Terre des Homme

Ruppenkampstrasse 11a, D-
49084
Osnabruck, Germany
tel +49 541 7101 -0
fax +49 541 7072 33
email info@tdh.de
web www.tdh.de

United Nations Children's Fund (UNICEF)

3 United Nations Plaza,
New York NY 10017, USA
tel +1 212 326 7000
fax +1 212 887 7465
email netmaster@unicef.org
web www.unicef.org/media/media_fastfacts.html

UNICEF Innocenti Research Centre on Children's Rights

Piazza SS. Annunziata 12
50122 Florence Italy
tel +39 055 20 330
fax +39 055 24 4817
email florence@unicef.org
web www.unicef-icdc.org

United Nations High Commissioner for Human Rights (UNHCHR)

8-14 Avenue de la Paix, 1211
Geneva 2, Switzerland
tel +41 22 917 9000
email 1503@ohchr.org
web www.ohchr.org

War Child International

5-8 Anglers Lane, London NW5
3DG, UK
tel + 44 207 916 9276
fax + 44 207 916 9280
email info@warchild.org.uk
web www.warchild.org

World Bank – Early Child Development

1818 H Street, NW Washington,
DC 20433, USA
tel +1 202 473 1000
fax +1 202 477 6391
web www.worldbank.org/children

World Health Organization

Avenue Appia 20, 1211 Geneva 2,
Switzerland
tel +41 22 791 21 11
fax +41 22 791 31 11
email info@who.int
web www.who.int

World Tourism Organisation

Capitan Haya 42, E-28020
Madrid, Spain
tel +34 91 567 8165
fax +34 91 567 8219
email omt@world-tourism.org
web www.world-tourism.org

2. Organizata të Medias

Article 19

6-8 Amwell Street, London EC1R
1UQ, UK
tel +44 207 278 9292
fax + 44207 278 7660
email info@article19.org
web www.article19.org

Committee to Protect Journalists

330 7th Avenue, 11th Floor, New
York YK 10001, USA
tel +1 212 465 1004
fax +1 212 465 9568
email info@cpj.org
web www.cpj.org

European Broadcasting Union

Ancienne Route 17A, CH-1218
Grand-Saconnex, Geneva,
Switzerland
tel + 41 22 717 2111
fax + 41 22 747 4000
email ebu@ebu.ch
web www.ebu.ch

INDEX on Censorship

6-8 Amwell Street, London, EC1R
1UQ, UK
tel + 44 20 7278 2313
fax + 44 20 7278 1878
email contact@indexon-censorship.org
web www.indexonline.org

International Federation of Journalists

IPC-Residence Palace, Bloc
C, Rue de la Loi 155, B-1040
Brussels, Belgium
tel +32 2 235 22 00
fax +32 2 235 22 19
email ifj@ifj.org
web www.ifj.org

MediaWise Trust (formerly PressWise)

38 Easton Business Centre,
Felix Rd, Bristol BS5 0HE, UK
tel +44 117 941 5889
fax +44 117 941 5848
email train@mediawise.org.uk
web www.mediawise.org.uk

Young People's Media Network in Europe and Central Asia (YPMN)

c/o European Centre for Media
Competence, Bergstrasse 8, D-
45770 Marl, Germany
tel +49 2365 502480
fax +49 12 125 125 21981
email cschuepp@unicef.org

3. Faqe të Përzgjedhura Interneti

Advocates for Youth

Shërbim informacioni me qendër
në Sh.B.A.; seksion mbi
seksualitetin për të rinjtë
www.advocatesforyouth.org/glbqt.htm

BOES – Children's Rights Across the World

Lidhje shumë-gjuhësore me
organizata për të drejtat dhe
zhvillimin e fëmijëve.
www.boes.org

Child Helpline International
www.childhelplineinternational.org

Children's House
Lidhje me ekspertë të mirëqenies së fëmijëve.
www.child-abuse.com/childhouse

Children's Rights Information Network
www.crin.org

Dart Centre for Journalism and Trauma Europe
www.dartcentre.org/europe

Defence for Children International
www.defence-for-children.org

Bashkimi European (BE) – Programi i Rinisë
Informacion shumë-gjuhësh për rininë mbi Bashkimin Europian
http://europa.eu.int/comm/youth/index_en.html

Every Child
Organizatë bamirëse ndërkombëtare që punon në Europën Lindore, Ballkan dhe Kaukaz
www.everychild.org.uk

Human Rights Watch
www.hrw.org

International News Safety Institute

OJQ për mbrojtjen e gazetarëve
www.newssafety.com

Internet Watch
Lufta kundër shfrytëzimit seksual të fëmijëve nëpërmjet internetit
www.iwf.org.uk

Internews Network
Organizatë joqeveritare që mbështet median e pavarur në demokracitë e reja
www.internews.org

Media Activities and Good Ideas by, with and for Children (MAGIC)
www.unicef.org/magic

OJQ që merren me fëmijët dhe rininë
www.ngo.org/links/index.htm

Safer Internet Programme
Nismë e Bashkimit Europian mbi çështje të sigurisë së internetit
www.saferinternet.org/index.asp

World Radio Forum
www.worldradioforum.org

Youth Guardian Services
Mbështetje me bazë internetin për të rinj homoseksualë apo
www.youth-guard.org

